



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Gjuhë Italiane me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë,
letërsi dhe qytetërim italian, përkthim dhe interpretim”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Eliana Laçe

2. Dr. Alva Dani

Mars 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Italiane me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian, përkthim dhe interpretim”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhës Italiane
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Gjuhë Italiane me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian, përkthim dhe interpretim”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr.359, datë 21.09.1991
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 297, dt. 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/ 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Italisht/Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno cmërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	21 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	2019-2020: 60 2020-2021: 116 2021-2022: 92
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës:

Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Italiane” me profile “Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim italian”; “Përkthim dhe Interpretim”; “Gjuhë dhe Komunikim” ofrohet nga Departamenti i Gjuhës Italiane, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës. Katedra e Gjuhës Italiane, sot DGJI, u krijua më 1984, duke iu bashkuar tri katedrave të tjera të fakultetit Histori-Filologji. Më 1991, me VKM nr. 2141 datë 14.09.1991, krijohet Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, me 4 katedra (Gjuha Ruse, Angleze, Frënge, Italiane), të cilave u shtohen më pas edhe Katedra e Gjuhës Gjermane, Departamenti i Gjuhëve Sllavo-Ballkanike dhe departamenti i Gjuhës Spanjolle.

Njohja e emërimit të diplomës në Bachelor është miratuar me shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me Nr. Prot. 7897, datë 22.11.2005.

Aktualisht, programi i studimeve Bachelor në “Gjuhë Italiane”, është program i ciklit të parë të studimeve universitare, i klasifikuar në nivelin 6 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ai përman 180 kredite ECTS, zhvillohet me njëkohëzgjatje 3 vite akademike, në formën me kohë të plotë dhe i përgatit të diplomuarit për të përvijuar studimet në programe të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë, përkthimit dhe studimeve të specializuara gjuhësore.

Programi është në përputhje të plotë me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe synon të pajisë studentët me njohuritë bazë që i formojnë ata si profesionistë dhe mësues të gjuhës italiane.

Gjatë takimeve me autoritet drejtuese të FGJH konstatojmë se DGJI e ka orientuar veprimtarinë e tij drejt ndërkombëtarizmit, në themel të të cilit qëndron modernizimi dhe harmonizimi i kurrikulave dhe programeve të studimit me ato të departamenteve simotra në universitetet e huaja, shkëmbimi i stafit dhe studentëve, bashkëpunimi në projekte kërkimore dhe zhvillimore ndërkombëtare, rritja e vizibilitetit të punës kërkimore-shkencore të këtij departamenti.

Konstatojmë se Departamenti i Gjuhës Italiane, përgjegjës për programin Bachelor në Gjuhë Italiane ka një staf akademik të përbërë nga 21 anëtare, personel akademik efektiv, 4 anëtarë, personel akademik me kontratë dhe 1 personel ndihmës akademik (2021-2022). Stafi është i mirëkualifikuar dhe mbulon të gjitha orët e këtij programi studimi. Në përbërje të tij kemi 2 Prof. Dr, 4 Prof.As. Dr, 14 Dr dhe 2 Master.

Ky program i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm për herë të parë.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Gjuhë Italiane” me profile “Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim italian”; “Përkthim dhe Interpretim”; “Gjuhë dhe komunikim” fillon me ngritjen e grupit të punës, të përbërë nga ekspertë të fushës, me integritet profesional, të propozuar dhe të miratuar nga ASCAL, si dhe nga përfaqësuesja e ASCAL, Znj. Endra Velaj.

Procesi i vlerësimit të jashtëm synon të sigurojë një vlerësim objektiv dhe të paanshëm të të gjitha fushave dhe standarteve që duhet të verifikohen dhe plotësohen, me qëllim nivelin e përmbushjes së tyre në funksion të sigurimit të cilësisë që ofrojnë programet e studimit.

Vlerësimi i jashtëm bazohet në evidenca, Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) dhe në takimet e organizuara në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, me të gjitha strukturat dhe me të gjithë aktorët përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Gjuhë Italiane.

Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Italiane”, në FGJH, të UT, është:

- Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”,
- “Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë” miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021,
- Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB korrik 2022), i cili shoqërohet në sistemin elektronik AMS, nga 147 evidenca dhe 2 evidenca të tjera të shtuara me kërkesë të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm.

Gjithashtu, Grupi i vlerësimit të jashtëm u mbështet edhe në të dhëna dhe statistika online, lehtësisht të aksesueshme në faqen ueb të FGJH dhe UT. Gjatë hartimit të raportit, GVJ ka vepruar me ndarje pune, detyrash dhe përgjegjësisish të përcaktuara qartë për secilin anëtar. I gjithë informacioni i depozituar në sistemin elektronik u verifikua gjatë takimeve me strukturat drejtuese, stafet akademike, studentët dhe specialistët e zyrave përkatëse pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Grupi i vlerësimit të jashtëm shpreh vlerësim për mënyrën e komunikimit dhe gadishmërinë për bashkëpunim të të gjitha strukturave të Institucionit, pjesë e të cilit është edhe Departamenti i Gjuhës Italiane.



Me datë 11/01/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 1/7 Prot, Datë 11/01/2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS me datë 01/02/2023 dhe me shkresë zyrtare Nr. 199/1 Prot, Datë 30/01/2023.

GVJ pasi u njoh me komentet e bëra nga Universiteti i Tiranës lidhur me DRVJ, sqaron si më poshtë:

Komentet lidhur me plotësimin e sugjerimeve të Intitucionit:

GVB: 2) Përcjellim bashkëlidhur (hard-copy & CD):

- **Miratim për hapjn e grupeve mësimore-kërkimore, datë 03/10/2022 (rekomandim i bërë nga GVJ në faqen 12 të draft-raportit, Standarti II.2, Kriteri 2).**

GVJ e vlerëson të përmbushur këtë rekomandim, mbështetur në dokumentin e datës 03.10.2022, me nr. Prot 826/1, vënë në dispozicion nga Departamenti i Gjuhës Italiane në sistemin AMS me datë 25/01/2023 dhe me shkeresë zyrtare Nr. 72 Prot., me date 24/01/2023, ku konfirmohet ngritja e katër grupeve mësimore / shkencore brenda ketij Departamenti. Kjo vërtetohet edhe nga vet Universiteti i Tiranës, sipas shkresës zyrtare Nr. 199/1 Prot, Datë 30/01/2023.

GVB: 2) Përcjellim bashkëlidhur (hard-copy & CD):

- **Miratim për hapjen e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Italiane” (i cili vetëm në variantin digjital të dorëzuar nuk është i plotë për gabime teknike).**

Bazuar edhe në evidencën Nr. 401 Prot, Datë 21/07/2004 për reformën e sistemit të Bolonjës, GVJ shprehet se nuk ka asnjë rekomandim.

Për rekomandimet e tjera të lëna nga GVJ, Institucioni dhe Departamenti i Gjuhës Italiane, shprehin dakortesi të plotë.

Si përfundim, GVJ e ndryshoi sugjerimin për hapjen e grupeve mësimore, duke shtuar evidencat përkatëse dhe i përmbahet vlerësimeve të tjera që ka dhënë në Draft-RVJ.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Gjuhë Italiane”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Sipas evidencave <i>nr. 1.0.1, 1.0.2, 1.1, 1.2</i> dhe nga verifikimi gjatë vizitës së ekspertëve të jashtëm rezulton se programi i studimit “Bachelor në Gjuhë Italiane” ofrohet në përputhje me: -misionin e arsimit të lartë -rolin dhe misionin e Universitetit të Tiranës -Strategjinë e zhvillimit të UT -misionin e FGJH-së -misionin e Departamentit të Gjuhës italiane Rezulton se programi i studimit “Bachelor në Gjuhë spanjolle” nuk bie aspak ndesh me interesat kombëtare, por i respekton duke qënë në përputhje totale me to.
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit “Bachelor në Gjuhë italiane”, sipas evidencave <i>1.0.1, 1.4</i> , synon: - përgatitjen e specialistëve me formim gjuhësor e shkencor -rritjen e sigurisë dhe aftësisë së specialistëve në mësimdhënie, përkthim, interpretim e komunikim -pajisjen me njohuri shumë të mira të gjuhës së shkruar e të folur -zotërimin e përsosur të gjuhës shqipe -aftësimin në kompetencat filologjike dhe letrare -aftësimin për ndërmarrje të studimeve të mëtejshme Sa më sipër, rezulton që ky program studimi përmbush qartësisht dhe me korrektësi qëllimin për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Grupi i ekspertëve analizoi objektivat, qëllimin dhe misionin e programit të studimit “Bachelor në Gjuhë italiane” dhe vlerësoi se ky program studimi është i hartuar: - sipas objektivave, qëllimeve dhe misionit që mbart në vetvete Universiteti i Tiranës, (<i>Evidencat nr.1.0.2, nr. 1.0.3</i>) - sipas përcaktimeve në Statutin e UT-së (<i>Evidenca nr.1.0.1</i>) - në përmbushje dhe në përputhje me ligjin nr. 80/2015 - sipas Strategjisë së Zhvillimit të Departamentit të Gjuhës italiane (<i>Evidencat nr.1.1, nr. 1.2</i>)



	- sipas fushës së veprimtarisë së këtij departamenti (<i>Evidencat nr.1.5, nr. 1.9</i>)		
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Sipas evidencave <i>nr. 1.1, 1.10, 1.4</i> vlerësojmë se programi i studimit është hartuar dhe ofrohet me synimin e kualifikimit të nevojshëm për nxitjen e zhvillimit lokal apo kombëtar.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit të programit të studimit “Bachelor në Gjuhë italiane”, evidencat <i>nr. 1.0.2, 1.0.1, 1.1, 1.9</i> , vlerësojmë që ky program: - respekton institucionalisht fushat e deklaruara akademike të Universitetit të Tiranës dhe të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja - mbështetet kryesisht në Strategjinë e zhvillimit të UT-së dhe misionin e tij - mbështetet në Strategjinë e Zhvillimit të FGJH-së - mbështetet në Strategjinë e Zhvillimit të Departamentit të Gjuhës italiane
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Nga shqyrtimi i evidencave të dosjes së RVB-së rezulton se programi Bachelor në Gjuhë italiane është i mbështetur në Statutin dhe Strategjinë e Zhvillimit të UT-së, Strategjinë e Zhvillimit dhe Rregulloren e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja; Rregulloren e Departamentit të Gjuhës italiane, orientohet drejt ofertës akademike që mbështetet në drejtimitet e parashikuara në sa më sipër, duke i zbatuar përputhshmërisht.
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit “Gjuhë italiane” është në përputhje të plotë me: - strategjinë e zhvillimit të UT-së dhe FGJH-së, në të njëjtin drejtim emërtimi, organizimi, strukturimi (<i>Evidencat nr. 1.0.1, kreu VII, neni 87, 88, 89; nr. 1.0.3 pjesa e tretë; nr. 1.6, neni 11-13;</i>) - thelbin që ka të përcaktuar Fakulteti i Gjuhëve të Huaja për të gjitha programet e të studimit (<i>Evidenca nr. 1.6</i>) - gërshetimin e komponentit ndërkombëtar me atë global (<i>Evidenca nr. 1.9, fq. 3-4; nr. 1.0.2, fq 9</i>)

Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Grupi i ekspertëve vlerëson që objektivat e programit të studimit, drejtohen kryesisht nga studenti për formimin e tij me dijet, aftësitë dhe kompetencën profesionale (<i>Evidenca nr. I.9, fq. 3-4.</i>)</p> <p>Kjo vihet re qartë në mënyrën e konceptimit të ndarjes së lëndëve dhe moduleve sipas tipologjive. Profilizimi i programit është dukshëm drejt fitimit të kompetencave profesionale dhe arritjes së objektivave të vëna nga ky program studimit për krijimin e profilit të studentit akademik, profesional, të suksesshëm në karrierën profesionale (<i>Evidenca nr. I.4, nenet 2,3,4</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Pas shqyrtimit të evidences <i>I.10</i> vlerësohet se studimi i tregut të punës bazohet në të dhënat e marra në rang fakulteti, pra bazuar në studimet e kryera në një rreze të gjerë që përfshin të gjitha programet e studimit të FGJH-së. Pritshmëria pozitive është mbajtja e një databaze jo vetëm në rang fakulteti, por edhe nga vetë struktura, pra departamenti, ku operon ky program studimi për të qënë më të vetëdijshëm dhe objektiv në mundësitë e punësimit të studentëve. Kontakti me alumnin bëhet shumë mire në nivel fakulteti dhe komunikimi me punëdhënësit e fushave për të cilat përgatit ky program studimi duhet të bëhet dhe mbahet edhe nga vetë programi i studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Vlerësojmë se programi i studimit rezulton të ketë në strukturën e vet një grup-lëndësh që krijojnë përgjithësisht përfitim të kompetencave të nevojshme për t'iu përgjigjur nevojave të tregut të punës (<i>Evidenca nr. I.4, fq. 3, 6, 7.</i>)</p> <p>Objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive e shprehive dhe kompetencave që u përgjigjen tregut të punës (<i>Evidencat nr. I.4, nenet 12, 14; nr. 1.10</i>)</p> <p>Vlerësojmë se në funksion të arritjes së objektivave për garantimin e përfimit të dijeve sipas nevojave të tregut të punës, kryhen përditësime dhe ndryshime cilësore në programin e studimit (<i>Evidenca nr. I.9, fq.</i></p>

	4.5) të cilat analizohen pikësëpari nga grupet mësimore dhe, më pas, kalojnë për miratimin në departamet dhe në senat (<i>Evidenca nr. I.13</i>)		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.4	
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Pas konsultimit me dosjen, <i>evidence Aneks RVB Tabela 1,2,3</i> , vlerësojmë se stafi akademik përmbush fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit, ka aftësi, kompetenca dhe burime të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit, pasi rezultoi se: - numri i pedagogëve me tituj akademik është i konsiderueshëm - numri i pedagogëve me gradë shkencore është mjaft i lartë - fushat e përgjithshme dhe specifike të programit janë në përputhje me profilin akademik dhe kërkimor të FGJH-së
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Nga shqyrtimi i dosjes dhe verikimi gjatë vizitave rezultoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Gjuhë italiane” është: - në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, si njësi kryesore (<i>Evidenca nr. I.4, neni 3</i>) - sipas klasifikimit ndërkombëtar për arsimin i cili lehtëson njohjen e programit dhe forcimin e bashkëpunimeve dhe të mobiliteteve (siti: http://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-fields-of-education-and-training-2013-detailed-field-descriptions-2015-eeen.pdf si dhe shtojca I, po aty)
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Nga shqyrtimi i dosjes dhe verikimi gjatë vizitave rezultoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Gjuhë italiane” është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Gjuhës italiane, si njësi bazë (<i>Evidenca nr. I.4, neni 3</i>) dhe sipas klasifikimit standard ndërkombëtar për arsimin(2013), brenda kodit 02 të fushë së gjerë, përkon me fushën e ngushtë të studimit, kodi 023, me specifikisht me fushat 0230 “Gjuhët pa përcaktime të mëtejshme”, 0231 “Përvetësimi i gjuhës”, 0232 “Letërsi dhe gjuhësi”, 0239 “Gjuhët pa klasifikime gjetkë” (siti: http://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-fields-of-education-and-training-2013-detailed-field-descriptions-2015-eeen.pdf , fq. 14-15) Kjo lehtëson njohjen e programit dhe forcimin e bashkëpunimeve dhe të mobiliteteve

	(siti: http://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/international-standard-classification-of-education-fields-of-education-and-training-2013-detailed-field-descriptions-2015-eeen.pdf si dhe shtojca I, po aty, fq 14) (Evidencat I, 16, I.16, 1), I.16.2, I, 16.3, I.16.4)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Pas shqyrtimit të rregulloreve dhe statutit të IAL-së, rregulloreve të Njesisë kryesore, rregullorev të Njesisë Bazë, vlerësojmë se: <ul style="list-style-type: none"> - hartimi, mbikëqyrja dhe mbarëvajtja e programit janë përgjegjësi direkte e Departamentit të Gjuhës italiane (Evidencat nr. I.0.1, nr. I.2, nr. I.6) - detyrat dhe përgjegjësitë ndahen mes personelit akademik të Departamentit të Gjuhës italiane dhe atyre që vijnë nga departamentet e tjera. (Evidencat nr. I.0.3; nr. I.4 nenet 8,9; nr. I.6; nr. I.2, nr. I.15) - ka asistencë administrative, teknike dhe laboratorike të qenësishme (Evidencat nr. I.2; I.18) - realizohen analiza periodike për vlerësimin e performancës së stafit akademik sipas Paketës së Sigurimit të cilësisë. (evidence nr. I.0.4.1; I.0.4.2; I.0.4.3; I.0.5) - realizohen analiza vjetore për vlerësimin e performancës së programeve dhe nxjerrjen e përfundimeve (evidenca nr. I.0.4.2, I.0.7, I.20, I.19.1, I.19.4, I.19.5)
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.	Nga shqyrtimi i evidencave nr. I.17 dhe nr. 3.74 me objektiv evidentimin e ndërkombëtarizimit të programit të studimit rezulton që Departamenti i Gjuhës Italiane: <ul style="list-style-type: none"> - është pjesë e Memorandumve të bashkëpunimit të nëshkruara nga UT - është pjesë e programeve të bashkëpunimit me universitete të huaja për mobilitetet staf akademik dhe student Mungon informacioni për marrëdhënie bashkëpunimi me aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton	Nga shqyrtimi i evidencave I.0.6, I.0.7 vlerësojmë që:

raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	- raportimi analitik periodik mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit është pjesë e analizës vjetore të Departamentit të Gjuhës italiane në krah të raportimit analitik mbi aktivitetin shkencor të pedagogëve në botime dhe në pjesëmarrje në konferenca brenda dhe jashtë vendit, si dhe me mobilitetet e stafit dhe të studentëve (<i>evidence nr. I.17</i>)		
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Nuk ka evidence për shqyrtim pasi ky program studimi nuk parashikon komponentin praktik, i cili rezulton të jetë i zbatueshëm në programin e dytë të studimit.		
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nga bisedat gjatë vizitave të grupit të punës vlerësojmë se stafi i këtij program studimi përfshihet në trajnimet profesionale e ofruara në rang fakulteti për studentët e diplomuar.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga shqyrtimi i evidencave <i>nr. I.8.1, I.8.2, I.8.3, I.8.4</i> vihet re se programi i studimit "Gjuhë italiane": - është i organizuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 42 të ligjit nr. 9741/2007 - është i organizuar si cikël i parë i studimeve me kohëzgjatje 3 (tre) vite, me 180 kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) - është i organizuar në lëndë dhe module të shpërndara në semestra, sipas raportit teori-praktikë

<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Vlerësojmë se programi i studimit “Bachelor në Gjuhë italiane:</p> <ul style="list-style-type: none"> - i referohet nivelit 6 të KSHK-së, Ligji Nr. 10 247, datë 4.3.2010) - synon formimin e shprehive mbi komunikimin (<i>Evidenca nr. I.4, neni 5, pika 2</i>) - përgatit specialist të gjuhës italiane, të përkthimit dhe komunikimit, duke ofruar formim të gjerë për profesionistët dhe specialistët (<i>Evidenca nr. I.4, neni 5, pika 2</i>)
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Vlerësojmë se programi i studimit “Bachelor në Gjuhë italiane” ofron njohuri në nivel të përparuar në rrafshin e të kuptuarit kritik dhe interpretimit kritik në shërbim të formësimit të studentëve për punësimin e tyre. (<i>Evidenca I.4, neni 3, 4, 5</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes vlerësojmë se për zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetenca të avancuara programi i studimit bazohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - objektivat e programit të studimit - tipologjitë e veprimtarive <p>Kjo evidentohet kryesisht nga evidencat nr. I. 8.1/2/3/4 dhe evidenca nr. I.4, neni 3.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Pas shqyrtimit të evidencave nr. I.8.1/2/3/4; nr. I.4, nenet 2, 3, 5, 9, 10, 11, 12, 19; nr. II. 1; nr. II. 2; nr. II.2.1, grupi i ekspertëve vlerëson se strukturimi i programit të studimit përmban të gjitha elementet përbërëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndarjes në vite studimi - ndarjes në semestra - lëndëve/moduleve - kontrollit të dijeve; - objektivave formuese dhe kompetencave profesionale - planit mësimor - vlerësimit përfundimtar - kuotat e pranimit dhe grupet mësimore - programit lëndor - profilit e programit - diplomës dhe suplementit <p>të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të</p>	<p>Bazuar në <i>evidencën II.13 – Rregullore diplomimi e ciklit të parë, Bachelor</i>, si dhe në <i>evidencën nr. I. 8.1/2/3/4</i>, vlerësojmë se programi i studimit “Gjuhë italiane” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/ modulet, përgatitjen e tezës së diplomës sipas kategoritë të</p>




përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	përcaktuara sipas shtojcës 1, tabela 1, VKM nr, 41, dt. 24.01.2018 me përqindjen dhe me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë: -lëndë bazë me 36 kredite = 20%; -lëndë karakterizuese me 90 kredite = 50%; -lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese me 28 kredite = 15.5%; -lëndë plotësuese me 20 kredite = 11.2%; -detyrime përmbyllëse me 6 kredite = 3.3%; Çdo lëndë/modul dallohet nga emërtimi sipas gërmave (A në gjuhën shqipe, B në gjuhën italiane, C dhe D në gjuhë të tjera – anglisht, frëngjisht, gjermanisht, greqisht, turqisht, spanjisht, etj.) dhe numri i krediteve.		
Sakalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Nga shqyrtimi i RVB-së, grupi i ekspertëve vlerëson se, sipas evidencave <i>nr. I.0.1, I.18, Aneks RVB</i> , si njësia kryesore ashtu edhe njësia bazë, në organizimin e tyre përmbushin detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim. Autoriteti drejtues është dekani i fakultetit. Departamentet drejtohen nga përgjegjësi i njësisë bazë, ku personeli akademik përmbush numrin e pedagogëve dhe të gradave shkencore dhe titujve akademik për të bërë të qenësishëm një departament. Departamenti i Gjuhës italiane përmbush detyrimet ligjore pasi është njësi bazë që bashkon fusha kërkimi homogjene.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Nga shqyrtimi i evidencave <i>I.01, I.18, I.2, II.3</i> dhe takimet gjatë vizitave, grupi i ekspertëve vlerëson në lidhje me këtë kriter, se në departamentin e gjuhës italiane ekzistojnë dhe veprojnë në bashkëpunim të vazhdueshëm me njëri tjetrin: - përgjegjësi i departamentit - koordinatori i programit të studimit, - komiteti shkencor i programit të studimit. <i>Evidenca Nr. 72 Prot., Date 24/01/2023</i> <i>Evidenca Nr. 826/1 Prot., Date 03/10/2022</i> <i>Evidenca Nr. 199/1 Prot., Date 30/01/2023</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore	Pas shqyrtimit të <i>evidencës Aneks RVB, tabelat 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, Evidencave I.6 dhe nr, I.0.1</i> , vlerësojmë se struktura akademike e FGJH-së si dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmes Përgjegjësit të Njësisë

dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Bazë, personelit akademik dhe joakademik në përbërje përbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.		
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Nga shqyrtimi i <i>Aneks RVB (Tabelat 1.1, 1.2, 1.3, 2.1, 2.2, 2.3, 2.4)</i> , grupi i ekspertëve vlerëson se Departamenti i Gjuhës Italiane përbush detyrimet për: -numrin: 21 personel akademik me kohë të plotë -shkallën e kualifikimit: 3 (tre) Profesor Doktor, 4 (katër) profesorë të asociuar, 13 (trembëdhjetë) me gradën shkencore doctor shkencash dhe 1(një) lektor MAECI		
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Vlerësojmë se struktura akademike e FGJH-së si dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmes Përgjegjësit të Njesisë Bazë, personelit akademik dhe joakademik në përbërje përbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike (<i>Aneks RVB, tabelat 3.1, 3.2, 3.3, 3.4; Evidencat I.6 dhe nr. I.0.1</i>)		
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi II.3 Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Nga shqyrtimi i evidencave <i>I.8.1/2/3/4</i> /vlerësojmë se FCJH dhe Departamenti i Gjuhës Italiane disponojnë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, që përmbledh: - programin e studimit - objektivat formuese - planin mesimor - lëndët/modulet - kreditet vjetore dhe të lëndëve/moduleve - strukturën akademike
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Pas shqyrtimit të <i>evidencës nr. I. 8.1/2/3/4, tabelat 9, 10</i> , grupi i ekspertëve vëren se programi është i organizuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, shtojca 1, tabela 1, VKM nr, 41, dt. 24.01.2018, sipas: - tipologjisë së veprimtarive me ndarjen në kategori - tipologjisë së lëndëve (bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese) me përqindjet përkatëse - lëndët/modulet me emërtimin dhe numrin e krediteve

	- detyrimeve përmbyllëse
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Pas shqyrtimit të <i>evidencave nr. I.0.1, nr. I. 8.1/2/3/4, Nr. II.8</i> , grupi i ekspertëve vlerëson se: - programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe module me kreditet përkatëse bazuar në sistemin vendas dhe evropian. - plani mësimor konceptohet në tre vite akademike me një total prej 6 (gjashtë) semestrash sipas strukture që shpallet në fillim të vitit nga dekani i fakultetit.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Nga shqyrtimi i <i>evidencës nr. I.14 dhe Aneks RVB Tabela 10</i> , grupi vlerëson se plani mësimor përmban: - tipologjinë e lëndës/modulit, - kreditet, - orët javore të leksioneve dhe seminareve, - orët individuale të studentit jashtë auditorit, - frekuentimi përcaktohet në fund të syllabus-eve të lëndëve/moduleve
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Grupi i ekspertëve vëren se ky program studimi u ofron studentëve informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit pasi: - kriteret dhe kuotat e pranimit bëhen publike përmes publikimit të vendimeve të SA në faqen zyrtare online të UT-së dhe të FGJH-së. (<i>Evidencat nr. I.0.1, nr. I.0.3., linqet e UT-së, evidenca II.4</i>) - pranimet kryhen në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 74 të Ligjit 80/2015 dhe udhëzimeve të përvitshme të MASR-së. (<i>evidencat II.0, nr. II.1, nr. II.2, nr. II.2.1</i>)
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet e lëndëve (syllabuset) hartohen nga titullari i lëndës sipas formatit standart të përcaktuar në <i>VKM 41/2018, shtojca 2 (Tabelat 14, Aneks RVB)</i> . Vërehet, nga shqyrtimi i syllabuseve të paraqitura në dosjen e RVB-së, se në to parashikohet informacioni për: - lëndën, emërtimin, titullarin, ngarkesën, numrin e krediteve, numrin e orëve, tipologjinë e lëndës, adresën elektronike të titullarit - temat e leksioneve, seminare, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve - literaturën bazë dhe të detyrueshme - frekuentimi dhe detyrimet e studentit. (<i>Evidenca nr. 2.1, 2.4, 2.5, 2.12</i>)
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen	Nga takimet dhe shqyrtimi i dosjes, grupi i ekspertëve vlerëson se departamenti ka si objektiv përmirësimin e përmbajtjes së kurrikulës me ndryshimet përkatëse përmes analizës vjetore të departamentit, ngritjes së grupeve të punës, të cilat miratohen nga SA (<i>Evidenca I.20, I.13</i>)

ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Vlerësojmë se ngarkesa e programit të studimit bazohet në <i>VKM Nr. 41/2018</i> , dhe nivelit 6 ne KSHK. <ul style="list-style-type: none"> - Programi shtrihet në tre vite akademike me 6 semestra. - Ngarkesa mësimore javore në auditor është mesatarisht 23 orë/javë, sipas pikës 2.1/d e VKM-së nr. 41/2018 - Programi përmban 42 lëndë (<i>Aneks RVB. Plani mësimor sioas modelit të Tabelës 10 dhe Evidenca I.4, neni 9</i>) - Sasia e krediteve vjetore është 60. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve mësimore vjetore. (<i>Evidenca II.8; Urdhër i brendshëm Nr. 41 dt 15.05.2019, Urdhër i brendshëm Nr. 18 dt 01.03.2021, Urdhër i brendshëm Nr. 59 dt 22.05.2021</i>)
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Grupi i ekspertëve vlerëson në shqyrtim të <i>evidencës I.4, neni 9</i> , se programi përmban: <ul style="list-style-type: none"> - lëndë të emërtuara dhe grupuara sipas kategorive: bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese dhe plotësuese; - lëndë të bazuara në objektivat formuese të programit të studimit (<i>evidenca I.8.1/2/3/4</i>); - shpërndarjen e duhur për përfitim të njohuri gjuhësore, kulturore e letrare (<i>evidenca I.8.1/2/3/4</i>); - formimin profesional në mësimdhënie, në komunikim dhe përkthim, për përshtatjen me tregun e punës (<i>evidencat nr. I.8.1/2/3/4 dhe nr. I.10</i>)
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektiveve formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të	Grupi i ekspertëve vlerëson se shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore, raporti teori-praktikë mundësojnë arritjen e objektiveve formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional (<i>evidenca I.8.1/2/3/4, Aneks RVB, tabela 9</i>). Nga analiza e <i>evidencës I.8.1/2/3/4</i> të programit dhe planit mësimor vlerësojmë se:




<p>nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - lëndët e vitit të parë synojnë formimin dhe zhvillimin e kompetencave bazë, sidomos gjuhësore; - lëndët e vitit të dytë synojnë formimin dhe zhvillimin e kompetencave hulumtuese dhe shkencore; - lëndët e vitit të tretë synojnë formimin profesional sipas profileve të këtij programi studimi. <p>Një shpërndarje e tillë është plotësisht në funksion dhe në zbatim të objektivave të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë italiane".</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Nga analiza e evidencave, grupi i ekspertëve vlerëson se struktura e programit është në përputhje me profilin e programit të studimit i ndarë në vite e semestra.</p> <p>Lëndët/modulet dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite sipas sistemit shqiptar dhe atij european janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - në referencë të përcaktimeve për nivelin 6 KSHK (Ligji Nr. 10, dt. 4.3.2010, fq 8-9) - në përputhje me profilin e programit bachelor të bazuar në Deklaratën e Bolonjës (<i>evidencat nr. I.8.1/2/3/4; nr. I.4, nenet 3, 17, 18</i>) - të përafërta me programe të ngjashme ndërkombëtare (<i>evidenca nr. I.16.1/2/3/4</i>) - në përputhje me profilin e programit (<i>evidence nr. I.8.1/2/3/4, Aneks RVB. Plani mësimor sipas Tabelës nr. 10</i>) - raport i balancuar teori-praktikë (<i>Aneks RVB. Plani mësimor sipas Tabelave nr. 9 e 10</i>)
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes e sidomos i evidencave të planit mësimor dhe të syllabuseve (<i>evidencave nr. I.8.1/2/3/4, nr. II.9</i>) vlerësojmë që ky program studimi, i bazuar në Deklaratën e Bolonjës, si rezultat i realizimit të objektivave formuese e krijon mundësinë e:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mobilitetit të studentëve - transferimit të studimeve (<i>evidenca nr. II.9, evidenca nr. I.16.1/2/3/4</i>) - punësimit (<i>evidence nr. I.10</i>)
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të evidencave <i>nr. II.7, Aneks RVB</i>, dhe vizitës në bibliotekën pranë FGJH-së, grupi i ekspertëve vlerëson se programet përditësohen në mënyrë të vazhdueshme me literature të viteve të fundit, pasi u verifikua përditësimi i vazhdueshëm i fondit të bibliotekës fakt që shërben në përditësimin nga ana e pedagogëve e syllabuseve të lëndëve dhe moduleve.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Vlerësojmë se kurrikula e programit bazohet në kompetenca sipas përmbajtjes së programit (<i>evidence nr. I.8.1/2/3/4</i>), i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - objektiva formuese, - kompetenca profesionale, - aftësi dhe kompetenca specifike të fushës si objektiv i ciklit të parë




<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Vlerësojmë se programi i studimit të ciklit të parë, sipas <i>evidencës I.12</i> mbi organigramën e programeve të studimit, krijon mundësinë e:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vijimit të studimeve në një cikël të dytë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” të ofruara nga FGJH, - formimit profesional në përkthim, komunikim e mësimdhënie (<i>evidenca nr. I.8.1/2/3/4</i>) - punësimin të menjëhershëm në fushën e përkthimit, komunikimit bazuar në kërkesën e kompanive italiane të pranishme në territorin shqiptar, e agjensive turistike për shoqërimin e turistëve italianë. 		
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Nga vizitat, grupi i ekspertëve vëren se për përmirësimin e përmbajtjes dhe përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, ky program studimi gjen mbështetje në strukturat përgjegjëse të ndërtuara nga FGJH si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e Këshillimit të Karrierës - Zyra e Alumnit <p>të cilat kryejnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - informimin e studentëve, - mbajtjen e të dhënave të secilit, - koordinimin e punës për orientimin e tyre drejt tregut të punës. <p><i>Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që Departamenti i Gjuhës italiane duhet të krijojë më tepër marrëdhënie të drejtpërdrejta me Alumni-n për të kuptuar problematikën e rënies së numrit të studentëve në mënyrë që të rimerret vijueshmëria dhe të rritet numri i maturantëve që përzgjedhin këtë program studimi.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e <i>evidencave nr. II.6, Aneks RVB Tabela 6</i> grupi i ekspertëve vlerëson se personeli akademik me kohë të plotë e të pjesshme përmbush kërkesat ligjore në fuqi pasi përmban numrin e duhur të pedagogëve që i përkasin kategorisë “Profesor” dhe “Lektor” të cilët plotësojnë kriteret ligjore të arsimit të lartë për ofrimin e programeve të studimit dhe për garantimin e cilësisë në mësimdhënie si në këndvështrimin profesional, ashtu edhe shkencor.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e <i>evidencave nr. II.6, Aneks RVB Tabela 6</i>, grupi i ekspertëve vlerëson se personeli akademik me kohë të plotë e të</p>




<p>dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>pjeshme përmbush kualifikimin shkencor për drejtimin e programit, dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit Bachelor në Gjuhë italiane. Rezultun se aktualisht në këtë program studimi janë të angazhuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 8 pedagogë të kategorisë “Profesor”, nga ku 3 Profesorë dhe 5 Profesorë të asociuar, - pedagogë të kategorisë “Lektor”, -2 pedagogë të kategorisë “Asistent-lektor” -1 lektor italian i mbështetur nga Ministria e Jashtme Italiane i kategorisë “Asistent-lektor” <p>Siç rezultun nga evidenca <i>Aneks RVB Tabela 2</i> dhe vizitat e grupit të ekspertëve, personeli akademik në realizimin e programit të studimit ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në <i>evidencën II.11 – Ndarja e ngarkesës mësimore</i>, grupi i ekspertëve vëren se personeli akademik që mbulon programin e studimit përmbush nivelin e kualifikimit në përputhje me programin e studimit pasi fushat e kërkimit shkencor të lëvruara nga personeli akademik përkojnë plotësisht me përfshirjen e tyre në mësimdhënien e lëndëve/moduleve të këtij programi studimi.</p> <p>Bazuar në <i>evidencat nr. II.10, nr. II.12</i>, grupi i ekspertëve vëren se personeli akademik që mbulon programin e studimit angazhohet rregullisht në organizimin e aktiviteteve kërkimore-shkencore, është pjesë e aktiviteteve shkencore dhe botimet në revista kombëtare dhe ndërkombëtare trajtojnë tema që janë në përputhje me programin e studimeve. Gjithashtu, konstatojme dhe vlerësojmë se personeli akademik i DGJI-së ideon, starton dhe zhvillon projekte shkëmbimi jo vetëm për stafin akademik, por edhe për studentët e këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit nuk ka komponent praktike, prandaj ky kriter nuk lidhet me te.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit</p>	<p>Nga vizitat ne IAL, grupi i ekspertëve vëren se departamenti i gjuhës italiane ka në dispozicion vetëm një person ndihmës akademik që siguron realizimin e detyrave për mbarëvajtjen e punës. Për realizimin e nevojave të tjera ka</p>




ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	mbështetje nga stafi ndihmës akademik, laborantë, specialist të IT-së në nivel fakulteti.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Nga analiza e evidencave <i>nr. 0.2, I.5, III.0.1</i> , grupi i ekspertëve vlerëson se ky program studimi operon sipas standardeve të vëna nga UT dhe nga FGJH duke hartuar dhe zbatuar përdorimin e udhëzuesve apo manualeve të ndryshme informuese rreth metodave të mësimdhënies, së fundmi edhe online, sipas specifikave të programit të studimi. Strategjia e FGJH-së (<i>evidence nr. I.5</i>) pasqyron vizionin e saj për politikën afatmesme dhe afatgjatë në inovacionin dhe integrimin e teknologjisë në mësimdhënie.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Sipas takimeve dhe evidencave të shqyrtuara <i>nr. III.0.2, III.6.1, I.0.4.1/2/3</i> , grupi i vlerësuesve të jashtëm vlerëson se pranë Njësisë Kryesore është ngritur struktura e NJSBC –së e cila ofron: - ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë, - monitorim periodik të performancës së personelit akademik dhe aftësive të tij mësimdhënëse përmes analizës së pyetësorëve në mënyrë drejtpërdrejt krahasues si midis përgjigjeve të studentëve, ashtu edhe midis rezultateve të viteve akademike. (<i>evidencat nr. I.19.1, nr. I.19.2, nr. I.19.3</i>)


	<p>- një proces transparent dhe gjithëpërfshirës përmes konsultimit të gjerë me stafin akademik.</p> <p>Vlerësojmë se NJSBC vepron çdo vit përmes vlerësimit të cilësisë së veprimtarisë mësimore të pedagogëve të këtij departamenti duke shfrytëzuar vlerësimin e lëndës nga studenti, vlerësimin e studentëve të diplomuar, vlerësimin për pedagogun (evidenca I.0.4/2/3).</p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Nga takimi me studentët si dhe nga shqyrtimi i evidencave I.0.3, <i>Aneks RVB. Te dhëna për anëtarët e NJSBCS-së (Tabela 24)</i>, grupi i ekspertëve vë në dukje se studentët ndjehen të përfshirë në vlerësimin periodik të formave e të metodave të mësimdhënies nga ana e pedagogëve përmes plotësimit anonim të pyetësoreve që institucioni iu ofron për këtë qëllim, në fund të semestrit apo vitit akademik.</p> <p>Gjithashtu, vërejmë se ankimimi i shkeljes së standarteve akademike, i shkeljes së procesit të mësimdhënies, i shkeljes së etikës akademike, i së drejtës së studentëve është i parashikuar në aktet rregullatore të brendshme të institucionit. Vërejmë nga analiza e evidencave të smësipërme dhe takimi me studentë që, studenti ka të drejtën e depozitimit të ankesës pranë përgjegjësit të njësisë bazë ose dekanit.</p>		
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga evidencat nr. II.6, II.2, III.2.1, si dhe nga takimet me strukturat përkatëse, por edhe me studentët, grupi i vlerësimit të jashtëm vëren se strukturat KPSSC dhe NJSBC ushtrojnë plotësisht veprimtarinë e tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> - duke publikuar rezultatet e vlerësimit, - duke vënë në dijeni përgjegjës të departamentit apo dekanin rreth rezultateve të dala pas përpunimit statistikor e cilësor. - duke hartuar çdo vit raportin vjetor të analizës dhe vlerësimit të brendshëm të programit të studimit. 		
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Sipas evidencave I.20, III.8.1/2/3/4, III.22, vlerësojmë se departamenti bën çdo vit akademik vlerësimin e performancës së personelit akademik, duke e vlerësuar, inkurajuar dhe promovuar atë drejt përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Standardi III.2
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes së departamentit, evidentohet se bazuar në rregulloret e UT/FGJH, të Departamentit të Gjuhës Italiane dhe të Programit të studimit Gjuhë Italiane; <i>Evidenca I.4, I.8.1/2/3/4, I.2, Aneks RVB; Tabela 13</i>, format bazë të mësimdhënies dhe mësimnxënies në këtë program studimi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - leksionet, - seminarët, - ushtrimet, - prezantimet, - detyrat/ projektet e kursit
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Sipas evidencave <i>nr. III.9, III.13</i>, dhe nga takimet me personelin akademik dhe studentët, grupi i ekspertëve evidenton që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pedagogët respektojnë rregullat e institucionit mbi mënyrën e zhvillimit të orës së mësimi, duke zgjedhur forma të ndryshme jo vetëm në mësimdhënie, por edhe në aktivizimin e studentëve - realizohet përdorimi i tabelave interaktive të instaluar në 11 auditore - përfshihen studentë në aktivitete alternative didaktike kërkimore - organizohen leksione të hapura me lektorë të huaj
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Nga takimet dhe vizitat e bëra si dhe nga <i>evidencat nr. I.0.1 dhe nr. 4</i>, grupi i ekspertëve vëren se personeli akademik i programit të studimit "Gjuhë Italiane" ndihet i mbështetur nga IAL në drejtimin e mësimdhënies dhe studimit, të edukimit të vlerave, të kërkimit shkencor, të infrastrukturës, të bashkëpunimit e partneritetit, të sigurimit të cilësisë, të shkëmbimit akademik, të mobilitetit të personelit akademik, të trajnimit në kuadër të programit Erasmus + KA 107 (<i>evidenca nr. I.16.3</i>).</p> <p>FGJH rezultojnë të zbatueshme strategjinë e modernizimit të metodave të mësimdhënies nëpërmjet teknologjive të reja përmes përdorimit të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Laboratorit të Fonetikës, - Laboratorit të kërkimit shkencor dhe i integritit të teknologjive të mësimdhënies, - Qendrës multifunktionale dhe e trajnimeve (<i>evidenca III.0.3</i>)
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme</p>	<p>Sipas evidencave <i>nr. I.19.3, fq.29; nr. III.10, nr. II.12, Aneks RVB, Tabela 6.1, 6.2, 6.3, 6.4</i> dhe takimeve me dekanen e FGJH, personelin akademik, drejtorin e departamentit të gjuhës italiane, grupi i ekspertëve vlerëson që personeli akademik i DGJI-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> - plotëson kriteret ligjore të kualifikimit - është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve




të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	- përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.		
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Sipas evidencave I.19.1/2/3/5 dhe II.7, grupi i ekspertëve vlerëson që personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike përmes: - analizës në departament dhe në grupet kërkimore shkencore - përthithjes së mendimit dhe sugjerimeve të studentëve, sidomos përmes pyetësorëve		
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Nga shqyrtimi i evidencave nr. 3.31, 3.16, Aneks RVB tabela 14, grupi i vlerësuesve të jashtëm, dhe nga takimi me pedagogët dhe studentët, vëren që personeli akademik gjatë orëve të mësimi: - ndërvepron me studentët - nxit të menduarit kritik të tyre. - shfrytëzon mjedise të pajisura nga pikëpamja teknologjike - përmirëson syllabuset me praktikën vendase apo të huaj		
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Sipas evidencave I.8.1/2/3/4, I.19.3 si dhe nga takimi me studentët u vlerësua që format dhe metodat e mësimdhënies ofrojnë: - përfshirje të studentëve - pavarësi komunikimi dhe shprehje mendimi të tyre - drejtim për nga të menduarit kritik - udhëzojnë dhe orientojnë studentët - krijojnë forma komunikimi të drejtpërdrejta ose online		
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Grupi i ekspertëve të jashtëm, sipas evidencave III.3.1, III.6, III.5, vlerëson se procesi mësimor e shkencor realizohet në: - një infrastrukture fizike, didaktike dhe logjistike të përshtatshme - hapësira të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor - hapësira të rikonstruara - hapësira në dispozicion të personelit dhe të studentëve në përpjesëtim me numrin e tyre




	- hapësira që plotësojnë kërkesat higjienike të personelit akademik dhe të studentëve
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Nga vizita në IAL, vlerësojmë se procesi mësimor realizohet në: - mjedise funksionale - mjedise të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor - laboratore me teknologji të kohëve të fundit - shfrytëzim të dy bibliotekave ekzistuese të pajisura me literaturë të pasur
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Nga shqyrtimi i evidencave <i>nr. III.0, nr. III.14, nr. III.14.1, nr. III.14.2</i> , grupi i ekspertëve vlerëson se personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë: - sisteme të ndryshme informatike - infrastrukturën e konsoliduar të IT-së - shërbimi wi-fi - adresat zyrtare email të stafit dhe studentëve Nga evidencat <i>nr. III.0.4 dhe nr. I.18</i> , vërejmë se në dispozicion të njësisë kryesore ka personel IT për asistencë teknike të shpejtë e të plotë.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i evidencave <i>nr. I.8.1/2/3/4/ dhe nr. II.7</i> , linkut të Bibliotekës online dhe nga takimet me pedagogë e studentë, vlerësojmë se literatura bazë dhe ndihmëse në dispozicion të studentëve garanton marrjen e dijeve dhe njohurive, pasi çdo fillim viti bëhet analiza dhe miratimi nga departamenti i literaturës bazë dhe ndihmëse për çdo lëndë e modul nga departamenti. Materiali vihet në dispozicion të studentëve fizikisht ose në mënyrë elektronike. Pedagogët dhe studentët e FGJH kanë akses në biblioteka online.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Sipas evidencave <i>III.12/12.1</i> , grupi i ekspertëve vlerëson se biblioteka e FGJH-së: - garanton një numër të mjaftueshëm botimesh në drejtimet kryesore të programit të studimit Bachelor në Gjuhë italiane - rezulton e pasuruar me një numër të konsiderueshëm librash të viteve të fundit - ofron tekst mësimor në formë elektronike në gjuhë të huaj - ofron hapësira të mjaftueshme dhe komode për studentët
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Vlerësojmë se në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit përmes: - shërbimit të bibliotekës online "U LIBRARY" - shërbimit të bibliotekës online JSTORE - shërbimit të faqes web të UT me akses në libraritë online <i>Evidenca III.12.2 dhe linku https://ulibrary.rash.al/</i>
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për	Nga vizita në ambientet e FGJH-së, takimet me personelin akademik dhe studentët, shqyrtimi i evidencave <i>III.5, III.12, Aneks RVB – Mjediset e</i>

realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	<i>Fakultetit/Njësive Bazë, Tabela 16</i> vlerësojmë se infrastruktura laboratorike, e përbërë nga laboratorë specifikë për përkthim / interpretim, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. Mjedise të tjera të shfrytëzuara nga studentët për kryerjen e detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike janë edhe bibliotekat Argjiro e Rozafa.		
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Nga takimi me personelin akademik dhe me studentët, vlerësojmë se personeli akademik dhe studentët përdorin platformën e-learning <i>Evidenca III.0.5 – Manual përdorimi platforma Teams version 1.0 për staf dhe student</i>) Teams, si një platformë për ofrimin studentëve të materialeve shtesë në funksion të mësimdhënies si pasurim i leksioneve dhe orëve të ushtrimeve. Pedagogu i lëndës ka mundësi që përmes kësaj platforme të ngarkojë materiale mësimore, si leksione, prezantime, detyra kursi dhe komunikime të tjera të aksesueshme nga studentët e këtij programi studimi.		
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Sipas linkut https://unitr.edu.al/aksesi-onkline/ , vlerësojmë se personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar. Platforma elektronike Teams shfrytëzohet nga institucioni edhe për trajnimet e stafit akademik, si dhe për trajnime të ndryshme të stafit akademik dhe të studentëve.		
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Vlerësojmë sipas <i>evidencës II.13</i> , se personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. Studimet në këtë program studimi përmbillen me provimin e punimit të diplomës. Studenti orientohet për metodologjinë, mënyrën e hartimit dhe stilin e punimit nga pedagogu udhëheqës.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me	Vlerësojmë nga shqyrtimi i <i>evidencave II.2. III.0.4. I.19.1, I.19.2, I.19.3, I.19.4, I.19.5, III.2</i> , se UT dhe FGJH kanë të organizuar struktura në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, si: - Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë

<p>njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) - Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës (KPK)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Grupi i ekspertëve vlerëson se Departamenti i Gjuhës Italiane është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në programet e studimit që ofron. Diskutohen raportet e anketimeve me studentët, dalin sugjerime dhe rekomandime. Studentët përfshihen në fushata informuese dhe promovuese me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë. (Aneks RVB, Tabela 24)</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Grupi i ekspertëve vlerëson se Departamenti i Gjuhës Italiane mbështet eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, përmes organizimit dhe pjesëmarrjes në trajnime/leksione për këtë qëllim. (Evidenca III.13)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Vlerësojmë sipas <i>evidencave nr II.12, nr. III.17 dhe evidencës Aneks RVB. Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit (tabela 19, 20.1, 20.2, 20.)</i> se personeli akademik i DGJI kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies, përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - botimeve, konferencave dhe aktiviteteve shkencore me aktor vendas e të huaj - mbështetjes së institucionit për kualifikim - pjesëmarrjes në aktivitete brenda e jashtë vendit <p>Vlerësojmë se në ndihmë të kualifikimit të stafit akademik dhe të pjesëmarrjes në aktivitete brenda e jashtë vendit, SA ka miratuar programe Granti. (evidencat nr. III.1.1, nr. III.1.3)</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Vlerësojmë se strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja (evidencat nr. I.16, nr. II.12)</p> <p>Trajnimi ndodh përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - projekteve sipas modelit trajno trajnerin (<i>projekti Re@WBC</i>) - programeve të shkëmbimit, - trajnimeve nga UT e FGJH, - pjesëmarrjes në programet Erasmus+
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e</p>	<p>Sipaa <i>evidencave nr. I.0.1, neni 74; nr. I.0.3</i>, vlerësojmë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve, - pedagogët janë përgjegjës në përgatitjen dhe përditësimin e programeve të lëndëve

mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	- pedagogët angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja (<i>evidence 1.2, neni 9 dhe I.5</i>) Gjithashtu, sipas evidencave I.0.1. I.2 dhe I.5, përgjegjës në zbatimin dhe ecurinë e procesit mësimor është edhe personeli ndihmës akademik i cili luan një rol të qenësishëm dhe shumë bashkëpunues.		
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Grupi i ekspertëve vlerëson, sipas <i>evidencave I.0.6 dhe I.0.7</i> , se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik aplikojnë metoda bashkëkohore në mësimdhënie, duke përdorur teknologjinë e informacionit. Ky fakt ka lehtësuar mësimdhënien sidomos në disa lëndë specifike duke e bërë mësimin interaktiv. Nga takimi me studentët grupi i ekspertëve vlerësoi që interaktiviteti rrit interesin e studentëve gjatë orëve të mësimit duke e bërë lëndën akoma më të qartë dhe më të kuptueshëm, Metodat e reja, sipas evidencave të mësipërme mbi raportet vjetore të UT-së, testohen nga personeli akademik përmes seminareve, workshop-eve apo aktiviteteve të tjera të organizuara nga FGJH-ja.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive njihen nga studentë pasi përcaktohen në rregulloren e UT-së, FGJH-së dhe të programit të studimit (<i>Evidenca I.0.3, I.5, Aneks RVB Tabela 15.</i>) Mënyrat e vlerësimit të dijeve përcaktohen nga pedagogu dhe paraqiten në syllabusin e lëndës dhe i bëhet me dije studentit (<i>sipas Aneks RVB, Tabela 15 dhe takimit me studentët</i>)
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Grupi i ekspertëve, sipas evidencave <i>nr. I.8.1/2/3/4 dhe nr. I.4</i> dhe nga takimi me personelin akademik, vlerëson se çdo fillim semestri studentët informohen me metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve	Grupi i ekspertëve, sipas evidencave <i>nr. I.8.1/2/3/4, nr. I.4, Aneks RVB, Tabela 15</i> , takimit me studentët dhe me personelin akademik, vlerëson se




dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	syllabuset e programit të studimit përmbajnë forma të larmishme të testimit të njohurive: vlerësim i kombinuar me shkrim/me gojë, vlerësim i vazhduar, vlerësim i detyrave, vlerësim përfundimtar.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Grupi i ekspertëve, sipas evidencave nr. I.8.1/2/3/4, nr. I.4, I.0.3, takimit me studentët dhe me personelin akademik, vlerëson se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive realizohet gjatë gjithë viti akademik përmes vlerësimit të vazhduar (provime të pjesshme, vlerësim të detyrave, eseve, projekteve).
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Vlerësojmë se Universiteti i Tiranës ofron sistemet elektronike të testimit TEAMS, e-students dhe CleanScor, sipas evidencave III.0.5, III.14, III.14.1. Këto sisteme përdoren përveçse për organizimin e procesit mësimor, edhe për organizimin e testeve dhe të vlerësimeve. Ky format organizimi dhe vlerësimi përmban objektivitet dhe transparencë, pasi informimi i menjëhershëm apo i shpejtë për vlerësimin përjashton çdo subjektivizmi nga ana e pedagogut në vlerësimin e dijes së studentit. <i>Propozojmë që ky format vlerësimi të jetë më i zbatueshëm, sidomos në lëndët që e lejojnë ofrimin e një vlerësimi të tillë.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Grupi i ekspertëve vlerëson se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. <i>(Evidenca III.19).</i> Nga shqyrtimi I evidences III.9 – <i>Kalendari I provimeve, komisionet e diplomave</i> , vlerësojmë se komisionet të cilat propozohen nga përgjegjësi I Njësisë Bazë dhe miratohen nga dekani, bëhen publike në mjediset e FGJH-së 2 javë para fillimit të sezonit të provimeve.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të	Grupi i ekspertëve vlerëson se ky program studimi organizon testimin e vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. <i>(Evidenca nr. I.0.3)</i>

monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Grupi i ekspertëve vlerëson se institucioni siguron infrastrukturën e posaçme të monitoruar me personel (komision për zhvillimin e procesit të provimit) (evidenca nr. III.0.6).
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Grupi i ekspertëve vlerëson se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback. Rezultatet shfaqen në e-student jo më larg se 48 orë nga dita e zhvillimit të provimit (evidenca I.8.1/2/3/4/, neni 50). Studentëve u jepet e drejta që të shikojnë individualisht tezat e korrigjuara nga pedagogu, të paraqesin konstatimet/ankesat. Pedagogu, sipas rregullores së FGJH-së dhe programit të studimit (evidenca I.4, neni 23) jep këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Sipas evidencave I.0.1, I.0.3, I.0.7 neni 5, f.4, III.0.6, Grupi i ekspertëve vlerëson se departamenti i gjuhës italiane dhe personeli akademik i tij zbaton rregulla për rastet e mashtrimit akademik (kopjimi në provime, detyra), plagjiaturën.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas evidencave III.20, III.0.6, I.4, Grupi i ekspertëve vlerëson se departamenti i gjuhës italiane dhe personeli i tij akademik bazon mbi meritë rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale dhe i jep ato në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga takimi me studentët, vlerësojmë se UT (Evidenca I.0.3) garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin për të gjitha format e kontrollit të dijeve të përcaktuara në syllabusin e lëndëve/modulit para se vlerësimi të jetë përfundimtar, në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studenti ka të drejtë: - të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës për vlerësimin e bërë - të ankohet për procedurën dhe rregullat e zhvillimit - të ankohet për rezultatin përfundimtar Grupi vlerëson se studentët e këtij programi studimi kur nuk binden nga rezultati kanë të drejtën të paraqesin kërkesë me shkrim pranë sekretarisë.
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Grupi vlerëson pas shqyrtimit të evidencave nr. I.0.3 dhe I.4, se çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm, sipas parashikimit në rregulloret e UT-së, FGJH-së, Departamentit të Gjuhës italiane, programit të studimit, që sanksionojnë të drejtën e studentit për ankimim. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.
	Përbushet kryesisht
	Përbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Grupi i ekspertëve vlerëson se programi i studimit “Bachelor në Gjuhë Italiane” zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive përmes veprimtarive formuese që e karakterizojnë sipas tipologjive të lëndëve/moduleve (<i>evidenca nr. I.8.1/2/3/4, Aneks RVB-Plani mësimor I ndarë sipas Veprimtarive formuese, Tabela 9; evidence nr. I.4, neni 11</i>). Grupi i ekspertëve vlerëson se programi i studimit “Bachelor në Gjuhë italiane” zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve në gjuhën italiane sipas objektivave të caktuara për këtë aftësim (<i>evidenca nr. I.4, neni 3 dhe evidencia nr. I.8.1/2/3/4</i>).
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Sipas <i>evidencave nr. I.4, Aneks RVB, tabela 9</i> , vlerësojmë se programi i studimit “Bachelor në Gjuhë italiane” garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën filologjike, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit si dhe teknologjisë së informacionit.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Sipas <i>evidencave I.19.3, I.13, II.7</i> vlerësojmë se, në përfundim të çdo lënde stafi akademik i angazhuar analizon punën e bërë me studentët gjatë kursit bazuar në rezultatet e arritura dhe vlerësimet e tyre nga pyetësorët. Vlerësimet e bëra nga studentët reflektohen edhe në ndryshimet në kurrikul apo në përditësime të programit të lëndëve në përmbajtje dhe në literature.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Grupi i ekspertëve vlerëson në bazë të <i>evidences nr. I.20</i> se në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre. Këto çështje analizohen edhe në analizën vjetore të punës në departament.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë	Vlerësojmë se në bazë të <i>evidences III.9</i> dhe takimit me personelin akademik të programit të studimit Bachelor në Gjuhë italiane, organizohen orë të hapura për studentët në nivel departamenti, por jo vetëm, duke ftuar ekspertë të fushës, vendas apo të huaj për seminare, leksione workshop-e rreth zhvillimeve të reja të shkencës.

strukturës së programit të studimit.									
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Vlerësojmë se mësimdhënia e stafit akademik realizohet mbi bazë kompetencash të parashikuara në kurrikulën e programit, sidomos në lëndët karakterizuese, por edhe në disa lëndë që zhvillohen kryesisht në laboratore (<i>evidence nr. I.8.1/2/3/4</i>). Disa nga lëndët e këtij programi rezulton se zhvillohen kryesisht në laboratorët që ndodhen në mjediset e FGJH-së.								
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Personeli akademik i Departamentit të Gjuhës italiane mbështet diskutimet dhe punën në grup të studentëve në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara sidomos gjatë orëve të seminareve dhe studimit individual, sipas përcaktimeve në programin lëndor, por edhe nga anketimi i studentëve. (<i>Evidenca I.19.3</i>)								
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Personeli akademik, sipas vlerësimit të GVJ nga komunikimi me personelin akademik, <i>evidencës Aneks RVB, tabela 22</i> krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve përmes organizimit të: - leksioneve të hapura me pedagogë të huaj të ftuar - konferencave studentore - shkollave verore - publikimit të thirrjeve të aktiviteteve shkencore								
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Vlerësojmë se Institucioni: - mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore përmes botimeve të studimeve të tyre në revista shkencore ndërkombëtare të drejtuar nga pedagogët - mbështet financiarisht studentët në organizimin e konferencave studentore (<i>Evidencat nr. III.3.2, III.3.6. III.7</i>)								
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Vlerësojmë se format e mësimdhënies së personelit akademik ndërthuren me format e mësimdhënies së institucioneve europiane me të cilët ky program studimi ka marrëveshje (<i>evidence Aneks RVB, Tabela 20</i>). Qëllimi është sidomos mobiliteti i studentëve. Rezultati është pozitiv pasi ka rritje të numrit të tyre në mobilitetet Erasmus+.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Grupi i ekspertëve, bazuar në <i>Evidencën I.0.3 dhe II.13, neni 5, 3, 6, 7</i>, dhe në takimin me personelin akademik, vlerëson se mbrojtja e diplomës realizohet sipas Rregullores së UT-së dhe Rregullores së Programit të studimit. Procedura bëhet publike me publikimin e rregullores dhe përmes takimeve informuese me studentët e vitit të tretë nga ana e drejtorit të departamentit dhe sekretarisë mësimore të fakultetit. <i>Evidenca III.16</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Vlerësojmë se, sipas <i>Evidencës III.16</i>, takimit me përgjegjësen e departamentit dhe studentët, asistojnë studentët për mbrojtjen e diplomës pasi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - studentët njoftohen me email nga përgjegjësjë e departamentit për pedagogët që do të udhëheqin temat e diplomës dhe fushat përkatëse - studentët ftohen me email nga përgjegjësjë e departamentit të përzgjedhin pedagogun udhëheqës dhe fushën që duan të trajtojnë - studentët vihen në dijeni për procedurën teknike të regjistrimit për punimin e diplomës - pedagogët udhëheqës kontaktojnë studentët për konsultimet dhe procedurat vijuese
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Vlerësojmë nga shqyrtimi i <i>evidences II.13, shtojca 1-5</i>, se komisioni për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike. Ai përfshin të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike dhe bazohet në vlerësimin me shkrim (30%), vlerësimin me gojë (30%) dhe mesataren e ponderuar (40%).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Vlerësojmë se, sipas <i>Evidencës III.13</i>, takimit me përgjegjësen e departamentit, personelin akademik dhe studentët, personeli akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - orienton studentët për zgjedhjen e temës së diplomës - ndihmon studentët për përgatitjen e temës së diplomës me orët e këshillimit - orienton dhe ndihmon studentët për t'u përgatitur për provimin final përmes komunikimit me email, ose takimit në departament
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Vlerësojmë se institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit vetëm përmes mundësisë për shfrytëzimin e bibliotekave (Argjiro dhe Rozafa) ose atyre virtuale (JSTORE, U-Library, COBISS) për marrjen e të dhënave sipas temave të përzgjedhura nga studentët në bashkëpunim me pedagogët përkatës.</p> <p>(https://unitir.edu.al/biblioteka-online/ ; U-library https://unitir.edu.al/ep-content/uploads/2019/11/Manual-p%C3%4Brdorimi-ulibrary.pdf / COBISS https://plus.cobiss.net/cobiss/al/sq/bib/search/</p>




<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Grupi i ekspertëve vlerëson sipas rregullores së diplomimit, se udhëheqësi i diplomës ndjek hapat e punës së studentit, udhëzon, jep disponibilitetin e tij gjatë shkrimit të punimit për të garantuar cilësi, miraton ose jo punimin sipas <i>Evidencë II.13, (Shtojca 1.1)</i></p>		
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas Rregullores së Programit të Studimit <i>Evidenca II.13, Shtojca 2-5</i>, në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>		
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Studentët e programit të Studimit “Bachelor në Gjuhë italiane”, në përfundim të studimeve, pajisen me diplomën “Bachelor në Gjuhë italiane” dhe Suplementin e Diplomës të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Diploma shoqërohet me listën e notave të tre viteve dhe me Suplementin e Diplomës. Suplementi hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. (<i>evidencat nr. I.0.3, Rregullore e UT, nenet 61, 63; nr. I.0.1, neni 110,111; nr. I.8.1/2/3/4/ Dosja e programit të studimit</i>)</p>		
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Vlerësojmë se në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion programi i plotë i studimit të zhvilluar në rast kërkesë nga ana e tij. (<i>Evidenca I.0.1, neni 125</i>)</p>		
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, pam se institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar regjistrin themeltar të të gjithë dokumentacionit të studentit, si të dhënat e studentit, vlerësimet gjatë tre viteve, të dhëna mbi diplomën dhe suplementin. Sekretaria mësimore ka përgjegjësinë e përpilimit dhe ruajtjes së të dhënave personale të studentit dhe i ofron ato në rast kërkesë.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
--	--	-----------------------------	------------------------------




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III				X
--	--	--	--	---

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Duke iu referuar Raportit dhe takimeve të zhvilluara me ekspertët dhe specialistët e zyrave përkatëse, rezultojnë se përgjegjësia për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit është kompetencë e Degës së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës. Dosjet e personelit akademik dhe atij ndihmësakademik, me karakter mësimor dhe administrativ në çdo program studimi, edhe për “Bachelor në Gjuhë italiane”, si dhe përditësimet vjetore të dokumentacionit të personelit mbledhen dhe ruhen nga kjo degë. Në nenin 64, kreu V, të Statutit të UT-s (Evidenca I.0.1), si dhe në kontratën e punës të personelit të angazhuar janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë lidhur me funksionin përkatës.
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe me aktet e brendshme rregullatore të këtij institucioni hartohen dhe zbatohen procedurat e rekrutimit të personelit akademik. (Evidenca I.0.1 neni 68-70) (Evidenca III.10). Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, Sektori i Burimeve Njerëzore ndjek procedurat e plotësimit të structures, duke iu referuar numrit të përgjithshëm të personelit në të gjitha nivelet, sipas vendimit të miratuar nga Bordi i Administrimit, që nga njoftimi për shpalljen publike të vendit të lirë në këndin “Njoftime punësimi” në faqen zyrtare Ueb të UT-s (shoqëuar nga linku i aksesueshëm), që përcakton vendin e punës, dokumentacionin e kërkuar, kriteret e pranimit, mënyrën e dorëzimit të dokumentacionit, afatet për aplikimin, deri në fund të procesit.
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve	Sipas Raportit të vlerësimit të brendshëm dhe vizitave me strukturat drejtuese të UT-se, konstatohet se procedura dhe kriteret e posaçme, specifike për rekrutimin e personelit, përcaktohen në nenet 67 dhe 68 të Statutit të UT-s dhe specifikohen në manualin “Mbi punësimin e personelit në UT” (Evidenca III.10).




rregullatore dhe i bën ato publike.			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar <i>Statutit të UT-s dhe manualit "Mbi punësimin e personelit në UT"</i>, pohojmë se institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi për përzgjedhjen e personelit, duke u mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura.</p> <p>Përcaktimi i kriterëve të veçanta të punësimit bazohet në nevojat e njësisë bazë, e cila shprehet me vendim të miratuar në mbledhjen e njësisë. Vendimi i departamentit i përcillet Rektorit nëpërmjet drejtuesit të njësisë kryesore. Rektori autorizon vazhdimin e procedurave të konkursit publik për vendin e punës për personel akademik dhe Drejtuesi i njësisë kryesore bën shpalljen e konkursit publik në APP si dhe në faqen zyrtare të njësisë.</p> <p>Drejtuesi i njësisë kryesore krijon komisionin <i>ad hoc</i> për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Rektori përcakton përfaqësuesin e tij në këtë komisionin, i cili ka në përbërje 5 anëtarë. Ky komision bën verifikimin paraprak të kandidatëve dhe përgatit relacionin përkatës. Bën njoftimin e kandidatëve që nuk kalojnë në fazën e dytë të konkurimit.</p> <p>Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza të njëpasnjëshme, që janë vlerësimi i dosjes dhe intervista. Komisioni <i>ad hoc</i> përcakton pikëzimin për çdo fazë të konkursit dhe për çdo kriter të shpallur.</p> <p>Komisioni shpall kandidatin fitues dhe bën publikimin në faqen zyrtare të njësisë kryesore. Konkurentët mund të ankimojnë vendimin pranë komisionit <i>ad hoc</i>.</p> <p>Rektori nënshkruan kontratën e punës dhe nga ky moment fillojnë marrëdhëniet e punës. Dosja personale e personelit akademik administrohet nga Drejtoria e Sherbimeve të Brendshme, Sektori BNJ në Rektorat dhe një kopje e dosjes i vihet në dispozicion edhe strukturave të Burimeve Njerëzore pranë njësisë kryesore.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nisur nga vizita e grupit të eksperteve në ambientet e e FGJH-së dhe duke iu referuar dokumentacionit që lidhet me Infrastruktura të këtij Institucionit, (Tabela 16.1 dhe 16.2 Aneksi RVB dhe Evidenca III.6) rezultojnë se mjedisi i punës është mjaft i përshtatshëm për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale dhe me standarde. Godina (A dhe B) në të cilën zhvillon aktivitetin edhe DGJI mundëson një mjedis universitar shumë të përshtatshëm për studentët. Në funksion të studentëve dhe stafit akademik janë vënë 33 salla seminaresh (1016m²) dhe 5 salla të mëdha leksionesh (487m²). 5 laboratorë në mbështetje të procesit mësimor, Laboratori i fonetikës (salla 213), Laboratori i kërkimit shkencor dhe i integritetit të</p>




	<p>teknologjive në mësimdhënie (214), Qendra multifunkionale dhe e trajnimeve të FGjH (salla 215), dy Laboratorë përkthimi dhe interpretimi (310, 313) dhe dy Bibliotekat (Argjiro dhe Rozafa) në godinën A.</p> <p>Me një sipërfaqe të brendshme prej 1800 m² truall, kjo godinë plotëson parametrat për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme pedagogjike dhe kulturore, duke evidentuar gjithashtu, nga grupi i punës së RVB, se kjo sipërfaqe përkon me 1.9 m² në dispozicion të studentëve nga 2.5 m² që është standardi për Shkencat Humanet dhe Artet.</p> <p>Nevojat për përmirësimin e mëtejshëm të mjediseve, paraqiten nga njësitë në kërkesat buxhetore të çdo viti (<i>Evidenca IV.3</i>).</p> <p>Në auditorë janë vendosur 11 tabela interaktive të cilat mundësojnë një mësimdhënie cilësore. Salla Evropa është pasuruar me 2 kabina të përkthimit. Gjithashtu, janë vënë në dispozicion 3 pajisje për Ueb konferenca, për organizimin e konferencave me pjesëmarrje online dhe klasat janë të pajisura me 19 projektorë.</p> <p>Përveç këtyre në përdorim të pedagogëve dhe studentëve është edhe auditori multifunksional (salla 315), i cili është pajisur në infrastrukturën e tij, me materiale digjitale dhe didaktike.</p> <p><i>Sugjerojmë një riorganizim të hapësirave fizike në shërbim të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit "Gjuhë italiane", për rritjen e cilësisë në përmbushjen e detyrimeve institucionale dhe akademike, pasi hapësira e zyrës së departamentit nuk e justifikon numrin prej 24 anëtarësh.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Duke u mbështetur në materialet zyrtare të RVB-së (link i aksesueshëm mbi verifikimin e trajnimeve të organizuara vazhdimisht nga Qendra e trajnimeve në UT) dhe nga takimet me personelin që mbulon dhe administron programin e studimit verifikojmë se kualifikimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi i mëtejshëm profesional i personelit akademik është jo vetëm pjesë e misionit dhe e objektivave të UT-së, por është edhe një punë konkrete e vazhdueshme që inkurajohet dhe mbështetet nga vetë institucioni. Në funksion të mbështetjes së misionit dhe objektivave janë hartuar disa strategji: Strategjia e zhvillimit të UT 2018-2023 (<i>Evidenca I.0.2</i>), Strategjia e zhvillimit të FGJH 2021-2024 (<i>I.1</i>), Strategjia e Teknologjisë dhe Inovacionit në Mësimdhënie e Nxënie (<i>Evidenca I.5</i>), Dokumenti i Strategjisë së zhvillimit 2021-2025 i DGJI (<i>Evidenca I.9</i>), Plani i Kërkimit shkencor të UT 2018-2022 (<i>Evidenca III.1.1</i>) link i aksesueshëm) dhe Strategjia e Ndërkombëtarizimit (<i>I.0.2</i>).</p> <p>FGJH ka mundur lidhjen e shumë marrëveshjeve të shkëmbimit, kryesisht në kuadër të programit Erasmus + (<i>linku bashkëngjitur mbi Marrëveshjet Ndër-Institucionale</i>). Referuar dokumenteve zyrtare që paraqet RVB, por edhe nga bisedat me stafin akademik, rezultoi se stafi i DGJI-së është ndër përfituesit kryesorë të projekteve të listuara dhe të dokumentuara (<i>Evidenca I.16</i>), (<i>Evidenca I.16.2</i>), (<i>Evidenca I.16.3</i>), (<i>Evidenca I.16.4</i>).</p> <p>Mbështetja financiare për pedagoget, për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare kombëtare, si dhe për rimbursim për botimin e artikujve në buletine shkencore jashtë vendit verifikohet në materialin zyrtar (<i>Evidenca III.3.1</i>). Angazhimi i stafik akademik dhe ndihmësakademik në projekte</p>

	kërkimore-shkencore verifikohet përmes tabelave 20, të vëna në dispozicion në Aneksin e RVB.		
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimit-shkencor.	Duke u mbështetur në një vendim të Rektoratit Nr.1 datë 13.01.2020, udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit dhe në Strategjinë e Teknologjisë dhe Inovacionit në Mësimdhënie e Nxënie FGJH (Evidenca I.5), stafi akademik është nxitur dhe motivuar për përdorimin e metodave dhe teknologjive të reja të mësimdhënies. Duke e verifikuar në linkun bashkëngjitur, rezultojnë se programet specifike për metodat novatore të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja në DGJI janë organizuar kryesisht në kuadër të projekteve përmes zbatimit të modelit 'train-the-trainer' (trajno trajnerin), disa prej të cilave në kuadër të projektit Re@EBC. Pedagogët shprehin se kanë gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e një procesi mësimit cilësor, duke përdorur metoda novatore me mjete teknologjike si: videoprojektor, shërbim interneti, laboratorë, biblioteka.		
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Gjatë takimit me pedagogët e DGJI dhe sipas tabelës 4, të Aneksit të RVB, dëshmohet angazhimi i Institucionit për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë të studimeve. Departamenti kryen ndarjen optimale të ngarkesës mësimore dhe asaj kërkimore shkencore sipas kompetencave profesionale të secilit pedagog, sipas planifikimit vjetor të kohës së punës. Po ashtu, stafi i DGJI promovon përvojën e kërkimit shkencor edhe me kolegë të tjerë të njëjësive bazë të FGJH, në funksion të rritjes cilësore si të kërkimit shkencor, ashtu edhe të procesit mësimit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Mbështetur në të gjithë dokumentacionin zyrtar shoqëruar (Aneksi, tabela 16, të dhëna mbi Infrastrukturën) dhe gjatë vizitës në të gjitha ambientet e FGJH pohojmë se FGJH disponon godinat A dhe B në godinën kryesore, ku janë dy fakultetet e UT-së, FGJH dhe FHF. Dy godinat kanë infrastrukturë të përshtatshme dhe moderne për zhvillimin e aktivitetit mësimit. Duke iu referuar orarit të mësimit, dhe nga sa pohohet në RVB rezultojnë se zhvillimi i mësimit bëhet në dy fasha orari të ndryshme, prej orës 08 ⁰⁰ deri në orën 14 ⁰⁰ për studentët e ciklit të parë "Bachelor" dhe mandej për studentët e ciklit të dytë "Master", duke iu krijuar mundësinë e përdorimit të mjedisëve akademike, jo vetëm gjatë këtij orari, por edhe më tej. Përveç mjedisëve ku zhvillohet procesi mësimit, studentët e DGJI-së mund të shfrytëzojnë edhe mjediset e Bibliotekave "Rozafa" dhe "Argjiro", që

	ndodhen në katin e dytë të Godinës A. Të gjitha mjediset, sallat, laboratorët, bibliotekat si edhe mjediset e tjera të shërbimit të administratës janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin cilësor dhe me standarde bashkëkohore të veprimtarisë mësimdhënëse.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita nëpër ambientet e FGJH-së në të gjitha katet e godinave dhe në të gjitha ambientet në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe nga bisedat me stafin e pedagogëve rezultoi se infrastruktura e teknologjisë së informacionit dhe pajisjet elektronike janë të gjitha funksionale dhe mundësojnë zhvillimin cilësor të procesit mësimor dhe atij kërkimor. Madje ata pohojnë se janë bërë edhe trajnime në lidhje me funksionimin dhe përdorin e tyre. Auditorët janë pajisur me 11 tabela interactive dhe 3 pajisje për Ueb konferenca. Salla Evropa (Godina B) ka 2 kabina të përkthimit për organizimin e konferencave apo veprimtarive me pjesëmarrje të huajve. Rezultoi se sallat e leksioneve janë të pajisura me kompjutera inteligjentë të inkuorporuar dhe të lidhur me sistemin e zërit dhe bokset për dëgjim. Pedagogët pohojnë se kjo ka lehtësuar shumë punën e tyre, sidomos gjatë periudhës së mësimin online. Gjithashtu, 19 projektorë janë të instaluar në auditorë. Departamentet dhe zyrat e FGJH janë të pajisur me laptop-ë, fotokopje skanerë e printera, për të cilat u mbështetëm edhe në materialin që lidhet me inventarin e Departamentit.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nisur nga vizita nëpër ambientet e fakultetit pohojmë gjithashtu, se FGJH disponon pesë laboratorë: 2 në katin e tretë të godinës A dhe 3 në katin e dytë të godinës B. Laboratorët janë të pajisur me mjete teknologjike si: kompjutera, kufje, kamera dhe videoprojektorë, si dhe mjetet e nevojshme të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të lëndëve specifike të programit si: fonetika, përkthimi etj. Një ndër laboratorët e vendosur në katin e tretë është konceptuar si sallë për praktikë mësimore, për prezantimin e punimeve dhe detyrave të ndryshme duke përdorur videoprojektorin dhe programe të ndryshme si poëer-point.
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Gjatë takimit me stafin e departamentit rezultoi që Laboratori (B 302), i vënë në përdorim për zhvillimin e moduleve të tilla si: Gjuhë e Huaj, Qytetërim, Fonetikë, Kërkim-Shkencor, Histori etj, përdoret edhe për zhvillimin e lëndëve të informatikës. Nga sa pohohet edhe në raport dhe në evidencën bashkëngjitur, laboratori është i pajisur vetëm me programet bazë, softet specifike-profesionale (si ato të përkthimit simultan) për lëndën e përkthim-interpretimit, që janë paraqitur në kërkesat buxhetore të DGJI-së.
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin	Mbështetur në dokumentat e vëna në dispozicion (<i>Evidenca IV.10 dhe Evidenca IV.10.1</i>), rezultoi se FGJH ka një sërë memorandumesh dhe marrëveshjesh me insitucione brenda dhe jashtë vendit, të cilat bëjnë të mundur realizimin e një sërë veprimtarish dhe praktikash mësimore që realizohen gjatë tre viteve akademike dhe që mbulohen tërësisht me kapacitetet dhe logjistikën e vendosur në dispozicion (laboratorë, auditorë, biblioteka) nga FGJH, të cilat janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e tyre.




e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.				
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në ambientet e FGJH, verifikuam edhe infrastrukturën mbështetëse në dispozicion të mësimnxënies së studentëve të këtij programi studimi. Konfirmojmë dy biblioteka Argjiro dhe Rozafa në katin e dytë të Godinës A të Fakultetit. Në ndihmë dhe në mbështetje të studentëve punojnë edhe 2 (dy) specialistë. Bibliotekat shërbejnë si për të shfrytëzuar literaturën sipas lëndëve apo moduleve, ashtu edhe si mjedise leximi dhe zhvillimin e aktiviteteve në shërbim të procesit mësimor. Natyrisht studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë edhe ambientet e bibliotekave të tjera, pas një procedure regjistrimi, te tilla si Biblioteka qendrore që ndodhet në Godinën e Rektoratit të UT dhe biblioteka e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Literatura fizike e dy bibliotekave, nga sa konstatuam në vizitë dhe nga sa na u tha nga specialisti i bibliotekës, është e pasur kryesisht me materiale për lexim dhe studim, siç janë: tekste, manuale, fjalorë, enciklopedi, periodikë, revista shkencore, libra artistikë, albume, CD në të gjitha gjuhët e huaja që mbulon FGJH. Referuar materialeve të vëna në dispozicion (<i>Evidenca III.11.1</i>) rrezultojnë se fondi i bibliotekës pasurohet me literaturë të re duke përfshirë të gjitha lëndët e programeve të studimit. Ka blerje të materialeve në gjuhën italiane në më shumë se një kopje. Nga komunikimi me studentët, rezultojnë se oraret dhe personeli janë në funksion dhe në përshtatje me oraret dhe mundësitë e studentëve (<i>Evidenca III.12</i>), madje ata shprehën se preferojnë më shumë bibliotekën fizike në krahasim me bibliotekën online.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Bibliotekat online, si shërbime të ofruara nga RASH dhe të mbështetura nga MAS, janë pa pagesë dhe të aksesueshme nga të gjithë studentët e programit të studimit. Studentët pohojnë se kanë punuar me JSTORE dhe U-Library, për të cilat është vënë në dispozicion edhe linku përkatës. Për bibliotekat online është vënë në dispozicion edhe manuali i përdorimit të tyre, siç mund të verifikohet lehtësisht edhe nga linku i aksesueshëm që shoqëron raportin. (<i>Evidenca III.12.1</i>) Në softin Cobib.al për digjitalizimin e katalogut bibliografik të koleksionit të Bibliotekave të UT përditësohen tekstat dhe artikujt shkencorë si pjesë e

	<p>rrjetit në sistemin ndërkombëtar Cobis.Net. Shërbimi i Bibliotekës digjitale është i aksesueshëm në linkun bashkëngjitur : https://ulibrary.rash.al/ Për krijimin e Bibliotekës elektronike online të UT është punuar me burimet elektronike për Shqipërinë [(Electronic Resources for Albania (ERA2012 Project))].</p>		
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Duke u mbështetur në bisedat me stafin akademik dhe nga ajo që u verifikua diteve të vizitës në ambientet e bibliotekave, pohojmë se bibliotekat e FGJH shërbejnë për veprimtari të ndryshme si konferenca, promovime librash, mbrojtje gradave e titujve shkencore, trajnime et, dhe janë të pajisura, përkatësisht: Biblioteka Argjiro: 3 kompjutera + 1 videoprojektor, 1 perde projektor, 1 fotokopje, 2 printera; Biblioteka Rozafa: 4 kompjutera, 1 videoprojektor, 1 perde projektor, 1 fotokopje, 2 printera; Numri i ulëseve: 40 + 40.</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në bazë të dokumentave shoqëruar dëshmohet se Departamenti dhe FGJH harton draft/buxhetin vjetor me nevojat për pasurimin e literaturës në fondin e bibliotekave (<i>Evidenca III.11.1 dhe Evidenca III.12</i>). Sipas nevojave të departamentit hartohet edhe lista e librave të nevojshëm me specifikimet teknike dhe kërkesës së studentëve në përputhje me programet e studimeve të përcaktuara (me titull të kërkuar, autor përkatës, shtëpi botuese, njësi, çmim, sasi, vlerë, ISBN për tekstet mësimorë dhe monografitë shkencore, ISSN për revistat/ buletinet, etj.). Duke iu referuar tabelës: <i>Blerje e librave për vitin akademik 2018-2019</i>, dëshmohet se koleksioni i bibliotekës pasurohet me librat e porositur, sipas një buxheti të planifikuar.</p>		
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Nga dokumentet e konsultuara pohojmë se bibliotekat e FGJH kanë orare shërbimi të përcaktuara dhe të përshtatura, në mbështetje dhe në përshtatje me nevojat e studentëve, pedagogëve dhe stafit të FGJH. (<i>Evidenca III.12</i>). Kapaciteti i dy bibliotekave është 80 vende (<i>Evidenca III.11</i>), por studentët e këtij programi studimi mund të shfrytëzojnë edhe bibliotekat e tjera të UT-së dhe sallat e tyre të leximit. Bibliotekat kanë edhe një rregullore të brendshme funksionimi (<i>Evidenca III.12.1</i>) Bibliotekat Argjiro dhe Rozafa janë të hapura: e hënë - e premte, ora 08:00-16.30. Në fundjavë dhe ditë festash bibliotekat janë të mbyllura.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit të zhvilluar në sekretarinë mësimore dhe nga sa raporton edhe grupi i punës në materialin e dorëzuar, dëshmojmë se institucioni administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe me aktivitetin e tyre. Sekretariatë mësimore, në zbatim të rregullores së brendshme (<i>Evidenca III.15</i>) dhe në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015, mbajnë në formë të shkruar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistrin themeltar të studentëve; 2. Regjistrin e arritjeve akademike ku hyn dhe procesverbali i çdo provimi apo detyrim tjetër akademik; 3. Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. <p>Sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje të brendshme, sekretaria është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për plotësimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistri, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët.</p> <p>Duke u bazuar në dokumentet zyrtare dhe në deklaratat e institucionit rezulton se në ndihmë të këtij procesi në UT funksionon edhe sistemi softëare e-Student, që mundëson shërbimet e nevojshme për çdo grup përdoruesish (<i>Evidenca III.14.1</i>). Mbështetur në vendimet e marra të institucionit pohojmë se sistemi e-Student është përmirësuar dhe optimizuar, së bashku me databazën relacionale të të dhënave në përshtatje me nevojat e kohës, në përshtatje me ndryshimet e zhvillimet e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe Rregullores së UT (<i>Evidenca III.14.2</i>).</p> <p>Për mbarëvajtjen e punës është vënë në dispozicion të përdoruesve, studentëve dhe pedagogëve, edhe manuali i përdorimit të sistemit e-Student, duke bërë që secili përdorues ta menaxhojë në mënyrë të pavarur llogarinë e tij.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Institucioni dëshmon se administrimi i informacionit, dokumentacionit dhe aktiviteti i personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe partnerëve të përfshirë në realizimin e programit, ende nuk është pjesë e platformës së e-student. Nga sa pohon specialistja e Zyrës së Burimeve Njerëzore pranë FGJH, Dega e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-arkivës është përgjegjëse për administrimin dhe ruajtjen e këtij informacioni. Në bazë të Rregullores së brendshme të Administratës së Rektoratit të UT (<i>Evidenca IV.1</i>) kjo degë menaxhon dokumentacionin personal të punonjësve, ndjek procedurat për shpërndarjen dhe grumbullimin e kontratave të punës për të gjithë punonjësit e UT, menaxhon afatet kohore të kontratave të punës për çdo punonjës, hedh të dhënat personale të çdo punonjësi në regjistrat themeltarë, nxjerr të dhëna nga dosjet personale ose librezat e punës për çdo punonjës.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi e-Student, përmes procedurave të përcaktuara në Manualin e përdorimit e-student dhe e-pedagog të UT (<i>Evidenca III.14/III.14.1</i>) siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente për personelin akademik dhe studentët. Çdo personel akademik e ndihmësakademik (Sekretaria mësimore) ka akses në llogarinë e tij, ku shfaqen të dhëna rreth kurseve, sezoneve të provimeve, oraret e tyre dhe listën e studentëve të regjistruar. Nëpërmjet këtij sistemi, pedagogu dhe/ose personeli ndihmësakademik</p>




	shfrytëzon dokumente të tipit procesverbale me rezultatet e studentëve sipas llojit të detyrës ose sezonit. Ndërsa studentët mund të aksesojnë informacione dhe të dhëna rreth statusit të tyre, lëndëve që mund të frekuentojnë, vlerësimet e çdo forme kontrolli në çdo lëndë etj.		
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Komunikimi midis stafit dhe studentëve në FGJH mundësohet përmes sistemit kompjuterik e-Student, i cili është një sistem transparent dhe interaktiv që mundëson shërbimet e nevojshme për çdo grup përdoruesish. (Evidenca III.14/III.14.1) Ky sistem ofron mundësi komunikimi interaktiv ndërmjet personelit akademik dhe ndihmësakademik dhe studentëve. Përveç këtij sistemi, UT disponon platformën TEAMS e cila mundëson çdo lloj komunikimi midis pedagogëve dhe studentëve (literaturë, leksione, vlerësime, detyra dhe projekte të kursit, etj). Personeli ndihmësakademik (Sekretaria Mësimore) nëpërmjet e-student akseson vërtetime të ndryshme, procesverbale notash, shlyerje detyrimesh etj.		
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Nga sa konfirmon grupi i punës sistemi kompjuterik e-student i UT, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Nëpërmjet këtij sistemi mund të monitorohen edhe afatet e hedhjes së vlerësimeve nga ana e personelit akademik.		
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të FGJH publikohen të gjitha njoftimet dhe informacionet që lidhen me programet e studimit, aktivitetin akademik dhe atë social-kulturor, personelin akademik, programet mësimore, oraret, datat e provimeve, thirrje për pjesëmarrje, struktura, etj. Informacioni është i disponueshëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Informacionet që lidhen me DGJI publikohen edhe në llogaritë në Facebook dhe Instagram.		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe	FGJH, në varësi të departamenteve dhe sipas secilit program studimi që ofron, realizon pasqyra financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat përfshihen në planin buxhetor të UT-së. UT harton në mënyrë periodike

<p>planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>raportin financiar të institucionit i cili paraqitet për miratim, si pjesë e raportit vjetor, pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit (<i>Evidenca I.0.6 dhe I.0.7</i>).</p> <p>Gjithashtu, institucioni pohon se në hartimin e buxhetit merren parasysh edhe të ardhurat e përafërta që priten të realizohen nga çdo departament/fakultet duke ndjekur një politikë favorizuese për departamentet që gjenerojnë më shumë të ardhura pa diskriminuar departamentet e tjera të cilët, për nga natyra e tyre, gjenerojnë më pak të ardhura.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Duke u mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, dëshmojmë se plani i financimit të programit të studimit përfshin në mënyrë të detajuar të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, shpenzime të tjera kapitale për laboratorë, fonde për aktivitete shkencore etj, me preventivat përkatës (<i>Evidenca III.3.6 dhe Evidenca IV.3</i>). Në fillim të çdo viti kryhet shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në UT, në përputhje të plotë me strukturën e Buxhetit të Shtetit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni kryen auditim të përvitshëm, të jashtëm dhe të brendshëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se Institucioni kryen auditim të brendshëm përmes Drejtorisë së Auditit të Brendshëm i cili është në varësinë e drejtpërdrejtë të Bordit të Administrimit. UT vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar i cili realizohet në mënyrë periodike, përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët si dhe ndarjen e burimeve financiare. Ky raport paraqitet prej administratorit të universitetit pranë SA dhe BA. (<i>Evidenca I.0.6</i>), (<i>Evidenca I.0.7</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe</p>	<p>Duke iu referuar RVB-së konstatojmë se FGJH ka të dokumentuara raportet financiare të tre viteve të fundit. Rektorati përgatit raportin financiar të realizuar, mbështetur në planifikimet e kryera në programin financiar. Realizimi i analizës financiare jep mundësinë edhe për ndërhyrje të posaçme</p>




planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	dhe diversifikimin eventual të financimit të secilit program studimi për të garantuar mbarëvajtjen normale të tij.		
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Sipas raportit financiar, institucioni dëshmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit dhe kapacitete të mjaftueshme për sigurimin në vijimësi të përmirësimit në të gjitha aspektet eprimitarinë e institucionit më qëllim rritjen e cilësisë akademike. Grupi i punës pohon se fondet e institucionit sigurohen nëpërmjet tarifave të regjistrimit, tarifave të shkollimit të studentëve, si edhe të ardhura nga shërbime të tjera për të tretët që ofron institucioni (qendra e trajnimit të mësuesve, qendra e kurseve të gjuhëve të huaja, qendra e mbrojtjes së gjuhëve të huaja). (<i>Evidenca III.3.2</i>)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin	Duke u mbështetur në dokumentet e vëna në dispozicion dhe nga takimet me drejtuesit e institucionit konstatojmë se Programi i studimit “Bachelor në Gjuhë italiane” ofrohet në përputhje të plotë me Ligjin (<i>nenet 73, 74 Ligji Nr. 80/2015</i>) dhe aktet e tjera në fuqi (<i>VKM Nr. 41, date 24.01.2018</i>). UT ka politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.

<p>në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Propozimet për kuotat e pranimit miratohen nga Senati Akademik. Kandidati fitues pas fazës së regjistrimit paguan tarifën e shkollimit sipas afateve të përcaktuara me vendime përkatëse të BA, të cilat publikohen në faqen Ueb të UT-së. Përmes disa vendimeve të posaçme të BA, UT ndjek edhe politika lehtësuese për tarifën e shkollimit. Çdo student i vitit të parë në fillim të vitit akademik pajiset me adresën elektronike personale në formatin emër_mbiemër.fgjh.student@unitir.edu.al që është një ndër formatet e komunikimit midis tij dhe UT (stafit akademik dhe sekretarisë mësimore), gjë që mundësohet përmes sistemit informativ e-student, i cili është një sistem i integruar për menaxhimin e procesit mësimor nga fitimi i statusit të studentit deri në përfundimin e studimeve që finalizohen me mbrojtjen e diplomës. (RVB).</p> <p>Rregullorja e programit të studimit dhe procedurat e diplomimit përcaktojnë qartë procedurat për realizimin e provimit përfundimtar. (Evidenca I.4). Për fitimin e diplomave të ciklit të parë, parashikohet përgatitja e një punimi mikroteze, i hartuar sipas kërkesave përkatëse. (Evidenca III.16)</p> <p>Sipas Rregullores së Diplomimit të Ciklit të Parë, komisionet përcaktohen nga përgjegjësi i departamentit dhe janë të përbërë nga 3 pedagogë efektivë të departamentit, ku njëri prej tyre është udhëheqësi i punimit. Komisioni i provimit të formimit administron provimin e formimit, i cili bazohet në tre shtylla: vlerësimin me shkrim (30%), vlerësimin me gojë (30%) mesataren e ponderuar (40%) (Evidenca II.13). Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës të miratuara nga MAS.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Departamentit të Gjuhës Italiane dëshmojmë se procedurat e zbatuara dhe politikat që ndiqen, nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit “Bachelor në gjuhë italiane”. Politikat e hyrjes dhe në vazhdim të studimeve në DGJI garantojnë barazinë gjinore, fetaçe pa diskriminime racore apo krahinore. Ky program studimi mund të ndiqet nga shtetas shqiptarë, shqiptarët nga trojet, romë dhe ballkano-egjiptianë, persona me status të caktuar (aftësi ndryshe, jetimë), si dhe nga çdo shtetas i huaj, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga FGJH, të miratuara nga SA dhe të bëra publike përmes mjeteve të informimit zyrtar, fletëpalosjeve dhe faqeve në rrjete sociale të UT. Nga bisedat me dekanen e fakultetit u deshmu edhe angazhimi i drejtpërdrejtë për mbështetjen e personave me aftësi ndryshe. Institucioni ka hartuar edhe një strategji të gjithëpërfshirjes, ku një ndër qëllimet kryesore është realizimi i aksesueshmërisë në mjediset e fakultetit dhe aksesueshmëria në informacion dhe në komunikim (Evidenca V.3)</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme,</p>	<p>Mbështetur në faqen zyrtare ueb të UT, në Statutin dhe Rregulloren e Ut-së konstatohet se kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. (Evidenca I.0.1), (Evidenca I.0.3).</p>




të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Sipas RVB, ky informacion mund të merret edhe pranë sekretarisë mësimore të FGJH-së, si dhe përmes mjeteve të tjera të informimit.						
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Njësitë bazë propozojnë kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve të cilat miratohen nga Senati Akademik dhe publikohen para fillimit të çdo viti akademik. (Evidenca II.2).						
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Në faqen zyrtare të UT-së janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimit bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, si dhe informacione të rëndësishme në lidhje me programin e studimit. Në bazë të dokumentacionit përkatës pohojmë se kuotat e pranimit të studentëve në këtë program studimi, të propozuara nga DGJH parashikojnë kuota për regjistrimin e studentëve të huaj (Evidenca V.6).						
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik, konkretisht siç edhe pohohet në RVB dhe në materialet që e shoqërojnë, përpara periudhës së plotësimit të formularëve të aplikimit të maturantëve, UT në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale, me njësitë bazë/kryesore të UT-së organizon takime me maturantët dhe vizita në mjediset e gjimnazeve të Tiranës dhe të Qarqeve, si dhe takime pranë Qendrave Rinore të qyteteve të ndryshme për të informuar të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programeve të studimit, duke shpërndarë broshura informative dhe duke dhënë informacion të detajuar për çdo program studimi. (Evidenca III.18) dhe (Evidenca II.4).						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të	Duke u mbështetur në materialin zyrtar të vënë në dispozicion dhe nga takimet e bëra me stafin akademik, si edhe nga takimet me studentët, dëshmojmë se Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të

studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	studentëve, përmes rregullores së UT-së, rregullores së programit të studimit dhe akteve të tjera rregullatore. Veç kësaj pedagogu i çdo lëndës, në fillim të kursit, prezanton studentët me programin mësimor, literaturën e lëndës, mënyrën e vlerësimit, rregullat e përgjithshme e çdo informacion tjetër për mbarëvajtjen e procesit mësimor. <i>(Evidenca II.8); (Evidenca III.19), (Evidenca IV.5).</i>		
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Institucioni ndjek procedura dhe ofron mundësi në lidhje me njohjen e krediteve, me transferimin e studimeve midis programeve të të njëjtit cikël studimi, në fillim të vitit akademik, brenda UT-së dhe në institucione të tjera të arsimit të lartë sipas përcaktimeve në Statut dhe në Rregullore. Nisur nga dokumentacioni bashkëngjitur <i>(Evidenca II.9)</i> , procedura e njohjes kryhet nga komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit për transferim, për regjistrim në program të dytë studimi dhe për ripranimet, i ngritur pranë DGJI-së. Procedura njohjeje kryhen edhe në periudhat e studimit që realizojnë studentët, në kuadër të programeve të shkëmbimit Erasmus. <i>(Evidenca V.1).</i>		
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga takimet me stafin akademik dhe nga dokumentacioni që disponojmë, pohojmë se përcaktimi i formës së vlerësimit të dijeve për lëndët e programit të studimit, bëhet nga pedagogu i lëndës, si dhe pasqyrohet në sillabusin e lëndës. Ndërsa kriteret e vlerësimit të dijeve të përcaktuara në programin e lëndës prezantohen dhe njoftohen nga pedagogu i lëndës në auditor ose përmes formave të tjera të komunikimit. Të gjitha informacionet janë të aksesueshme edhe online. <i>(Evidenca II.4) dhe (Evidenca I.4).</i>		
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni disponon një Rregullore të diplomimit dhe Procedura të qarta të diplomimit, të cilat përcaktojnë kushtet që një student të diplomohet, si dhe mënyrën e diplomimit, me punim eseje apo punim diplome. <i>(Evidenca II.13) dhe (Evidenca III.16).</i> Studentët informohen jo vetëm nga pedagogu udhëheqës, por edhe nga përgjegjësi i departamentit, kordinatori i programit apo sekretaria mësimore.		
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	FGJH ofron informacione në mënyrë periodike të organizuara, në ueb dhe në ditët e informimit të studentëve të ardhshëm të këtij programi studimi. FGJH ka hartuar dhe publikuar udhërrëfyesin e FGJH-së dhe fletëpalosje për t'u shpërndarë tek të interesuarit. Veprimtari të tilla si Open Day, Work and Study, Welcome Day, Panairot e punës etj, kanë për qëllim të njohin maturanët me programet e studimit që ofron FGJH. <i>(Evidenca II.4), (Evidenca III.18).</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Gjatë bisedave me studentët dhe mbështetur në materialet zyrtare të ofruara, konstatojmë se studentët në DGJI informohen në mënyrë të hollësishme, gjatë gjithë periudhës së studimit, për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. Informacioni ofrohet nga sekretaritetë mësimore, nga takimet e para me përgjegjësin e departamentit, kordinatori i programit dhe nga Zv.Dekani për marrëdhëniet me studentët, publikun dhe këshillimin e karrierës, dhe gjithashtu online : https://fgjh.edu.al/sherbime-dhe-informacione/		
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Duke iu referuar RVB-së dhe vizitave në institucion, rezulton se FGJH vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion mbi kurrikulën dhe programin e studimit, i cili mund të merret në faqen zyrtare ueb të FGJH, në platformën e-student dhe në hardcopy. Në stendat e DGJI mund të gjenden programi i studimit Bachelor, kurrikula e plotë, ndarjet e lëndëve në semestra, kreditet, etj.		
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Nga takimet me stafin dhe nga materiali që disponojmë vërejmë se po bëhet përpjekje në kuadër të mbështetjes institucionale të studentëve për orientimin drejt karrierës dhe tregut të punës. Zyra e Këshillimit të Karrierës, Alumni-t etj, u shërben studentëve të UT-së si urë lidhëse me tregun e punës, duke krijuar kontaktet e duhura dhe mundësi punësimi. (Evidenca I.11).		
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Konstatojmë se studentëve u ofrohet informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor për diplomimin, kalendarin akademik, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion është lehtësisht i aksesueshëm përmes disa alternativave: faqja zyrtare ueb, sekretaria, stenda e DGJI, programit të orientimit dhe sistemit e-student. (https://fgjh.edu.al/sherbime-dhe-informacione/ https://unitirana.edu.al/diplomimi/ https://fgjh.edu.al/struktura-akademike/)		
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes platformave TEAMS dhe sistemit E-Student, të cilat janë të shoqëruar me manualet përkatëse të përdorimit. (Evidenca III.05) dhe (Evidenca III.14). Këto hapësira funksionojnë shumë mirë dhe realizojnë bashkëpunim e komunikim interaktiv në distancë midis pedagogëve dhe studentëve.		
	<table border="1"> <tr> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Gjatë vizitës në institucion, grupi i vlerësimit u njoh me regjistrin themeltar të studentëve. Të gjitha të dhënat e studentëve ndër vitë, gjenden të regjistruara në databazën e sekretarisë mësimore dhe në regjistrin themeltar. Sekretaria disponon statistika për të diplomuarit në formë elektronike dhe hardcopy. Nga sa konfirmuam në sekretari, në dokumentacionin që konsultuam, numri i studentëve për tre vite akademike në këtë program është si më poshtë: Viti akademik 2021-2022 - 92 të regjistruar Viti akademik 2020-2021 - 116 të regjistruar Viti akademik 2019-2020 - 60 të regjistruar
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nga takimet në sekretarinë mësimore rezulton se i gjithë dokumentacioni në lidhje me studentët gjendet i arkivuar pranë sekretarisë mësimore. Sekretaria harton statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, të largimeve para përfundimit të programit apo të mospërfundimit me sukses të programit, si dhe të dhëna për ecurinë e tyre akademike deri në diplomim. (Evidenca I.0.6) dhe (Evidenca I.0.7).
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Deshmojmë se Institucioni disponon të dhëna mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve "Bachelor" që nga pranimi i studentit e deri në diplomimin e tij, të dhëna të cilat ruhen nga sekretaria mësimore e DGJI: regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Raportimet e të dhënave kryhen periodikisht.
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të	Sekretaria mësimore është një strukturë e posaçme, që merret me ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave statistikore. (Te dhëna nga RVB). Këto të dhëna janë të sigurta dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar. Siguria e tyre garantohet përmes platformave mbrojtëse (antivirus, firewall, etj). Të dhënat statistikore mbi procesin mësimor të studentëve të përmendura me lart menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit duke ruajtur konfidencialitetin.

verifikueshme nga personat e autorizuar.							
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Referuar dokumenteve në dispozicion rezulton se institucioni harton Raportin Vjetor me të gjithë elementet përbërës të tij, i cili hartohet bazuar në evidencat dhe raportet e njëjësive kryesore/bazë. Në Raportin Vjetor vlerësohet, ndër të tjera, veprimtaria mësimore dhe shkencore, si dhe ecuria e programeve që ofron UT. (Evidenca I.0.6). Zyra e Karrierës/Alumni-t është struktura përgjegjëse që gjurmon të diplomuarit dhe përditëson bazën e të dhënave, në bazë të rregullores së funksionimit kësaj zyre. (Evidenca V.2.1).						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Gjatë takimit me studentët dhe nga konsultimi i materialeve zyrtare, rezulton se studentët e DGJI janë të angazhuar dhe të përfshirë prej vitesh në këshillat studentorë në nivel institucioni dhe njësie kryesore përmes një procesi zgjedhor të administruar nga KIZS (Komisioni Institucional Zgjedhor i Studentëve). Duke u mbështetur në Statutin e UT-së, në aktet ligjore dhe ato rregullatore të vetë IAL-ve, në përbërjen e komisioneve të përhershme parashikohet një student, duke garantuar kështu përfshirjen në organet vendimmarrëse e këshilluese. (Evidenca III.1.2)
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në të gjitha strukturat ku përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve në UT. Në bazë të dokumenteve të vëna në dispozicion dëshmojmë se studentët janë anëtarë të komisioneve të përhershme të ngritura pranë UT si: Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënies me studentët, Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë së UT. Në kuadër të marrjes së masave për përmirësimin e programit të studimit, FGJH realizon një sërë focus grupesh me studentët, po ashtu dhe pyetësorë për të marrë feedback në lidhje me mënyrën e realizimit të programit të studimit. (Evidenca I.19.1, I.19.2, 3, 5).
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën	Ngarkesa akademike e studentëve në këtë program studimi është hartuar dhe zbatohet duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore të institucionit dhe në harmoni dhe me udhëzimet dhe vendimet e MAS. Programi "Bachelor në

akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Gjuhë italiane” është i shtrirë në gjashtë semestra me ngarkesë të barabartë, 30 kreditë për semestër, me një ngarkesë në auditor që nuk i kalon 22 orë në javë (leksione dhe seminare) (Aneks RVB, Plani mësimor). Për sa i takon njohjes së studimeve apo kualifikimeve të mëparshme, të pjesshme apo të plota; si dhe transferimit të tyre, ato bëhen nga Komisioni i ekuivalentimit (Evidenca II.9).		
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion përfshirjen e studentëve në procese të rëndësishme të zhvillimit të programit të studimit “Gjuhe Italiane”. Analizat dhe vlerësimet e pyetësorëve shërbejnë si bazë për diskutime dhe reflektime mbi përfundimet e dala nga këto raporte për FGJH dhe DGJI-në lidhur me lëndët e ofruara në program dhe aspekte që kanë nevojë për përmirësim. (Evidencat I.19).		
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në materialin zyrtar he në RVB, konstatojmë se Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultati. Kontrolli i dijeve është transparent. Në fund të vlerësimit gjithë studentët ballafaqohen me punën e tyre dhe rezultatin dhe ndjehen të lirë të shprehin rezervat apo ankesat në lidhje me rezultatin. Çdo ankimim shqyrtohet duke u bazuar në Rregullore. Sekretimi i provimeve, argumentimi i kërkesës për rivlerësim etj, janë tregues për transparencës në procesin e vlerësimit. (Evidenca I.4 neni 23), (Evidenca I.0.3, neni 50)		
Shkalla e përmbushjes së standordit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Duke iu referuar takimeve të zhvilluara dhe materialeve të vëna në dispozicion, vlerësojmë se Institucioni ka ngritur struktura organizative, në shërbim të informimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UT. Informimi i studentëve realizohet përmes Sektorit të Marrëdhënieve me Studentët (Evidenca III.0.4), Zyrës së Informacionit, Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Sekretarive mësimore. Gjithashtu, studentët ndihmohen, përmes orëve të konsultimeve, nga stafi akademik i programit të studimit.

<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Pohojmë se Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Stafi akademik dhe ai ndihmësakademik, orientojnë studentët drejt informimit dhe këshillimit të tyre në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre ofron, mundësitë e punësimit në të ardhmen, etj (Statuti dhe Rregullore e UT)</p> <p><i>Grupi i ekspertëve vëren mungesën e figurës së kujdestarit të studentëve, i parashikuar në Statutin e UT-së. Pavarësisht ekzistencës së një strukture drejtuese në shërbim të studentëve, që është Zv.Dekani për marrëdhëniet me studentët i cili lehtëson harmonizimin e marrëdhënieve me studentët, figura e kujdestarit me atributet që i cakton Statuti do të përbënte një hallkë të rëndësishme në këtë marrëdhënie.</i></p>										
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra Këshillimit të Karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhdueshme duke krijuar kontakte dhe marrëdhënie bashkëvepruese me punëdhënësit potencialë, me qëllim promovimin e studentëve dhe mundësi të reja punësimi për ta. Specialistët e strukturave të ngritura në mbështetje të studentëve, i asistojnë ata në shërbime që lidhen me studimin dhe mësimin, aplikimin dhe pranimin në programe për të studiuar, kurse akademike, progresin akademik dhe përfundimin e studimeve, për përfitimin e bursave dhe kredive studentore, organizimeve studentore etj; mbështesin, inkurajojnë dhe asistojnë jetën kulturore, artistike, kulturore e sportive të studentëve dhe organizimeve të tyre në këtë fushë. (Evidenca V.13)</p>										
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Nisur nga materialet zyrtare dhe nga takimet në institucion vlerësojmë punën e Qendrës së karrierës, që ka si qëllim bashkëpunimin e ngushtë me studentët dhe krijimin e mundësive të punësimit për studentët e diplomuar në FGJH, duke u krijuar edhe hapësira promovimi nëpër kompani, organizata etj. Aktiviteti kryesor i kësaj qendre konsiston në organizimin e ditëve të informimit, orëve të hapura, klubit të debatit, pjesëmarrje në Panairin e punës dhe karrierës dhe organizimin i shkollës verore. (Evidenca V.2.1) (Evidenca V.14).</p>										
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="550 1556 762 1624"></th> <th data-bbox="762 1556 975 1624"></th> <th data-bbox="975 1556 1187 1624">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1187 1556 1415 1624">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="550 1624 762 1693"></td> <td data-bbox="762 1624 975 1693"></td> <td data-bbox="975 1624 1187 1693"></td> <td data-bbox="1187 1624 1415 1693">X</td> </tr> </tbody> </table>					Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht								
			X								




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënlige në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>UT në zbatim të ligjit për arsimin e lartë si dhe në zbatim të Statutit të tij ka ngritur “Komisionin e përhershëm për sigurimin e cilësisë në nivel institucional”, në nivel Institucioni dhe Njësie Kryesore. Sektori i Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve. Në këto komisione janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme. Strukturat në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në dokumentet e rëndësishme për funksionimin e saj siç është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja për sigurimin e cilësisë • Manuali i cilësisë • Paketa e instrumentave të cilësisë. <p>UT drejtohet nga Strategjia e Zhvillimit 2018-2023, në mënyrë të qëndrueshme për përmbushjen e objektivave ekzistuese si dhe për hartimin e objektivave të reja, në lidhje me përmirësimin e cilësisë në UT, politikatat dhe masat operative që propozohen si pjesë e këtij plani etj.</p> <p>Institucioni ndjek procedura për përmirësimin e programeve të studimit duke filluar që prej analizimit të rezultateve të pyetësorëve deri në planin e masave që propozohet për përmirësim.</p> <p>Paketa e instrumentave ndihmon në monitorimin e cilësisë së shërbimeve që studentët marrin gjatë viteve të studimit në UT prej strukturave mbështetëse për programet e studimit, në vlerësimin e performancës së personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. (Evidenca I.0.4.1), (Evidenca I.0.4.2) (Evidenca I.0.4.3), (Evidenca I.0.2) (Evidenca III.2).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për</p>	<p>Gjatë takimeve në institucion dhe mbështetur në dokumentet bazë zyrtare (Evidenca III.1) (Evidenca III.1.2) dëshmojmë se Sistemi i brendshëm sigurimit të cilësisë, funksionon si një rrjet i mirëorganizuar dhe shtrin funksionin e tij në të gjitha departamentet e njësive kryesore. KPSSC është struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit</p>

<p>përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>dhe programeve të studimit. Ajo përbëhet nga 11 anëtarë, 8 personel akademik dhe 3 studentë. (Evidenca III.1) Në Komisionet e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë për çdo njësi kryesore dhe në nivel institucioni, si dhe në komisione të ndryshme <i>ad-hoc</i>, studentët përfaqësohen me një anëtar. Nga sa pohohet edhe në RVB, si pjesë e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, është edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm nëpërmjet organizimit të tryezave të rrumbullakëta.</p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Për sigurimin e cilësisë, institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë me studentët, stafin akademik, takimet në grup për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë, nëse është e nevojshme. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit. Në vitet 2017 dhe 2018, UT ishte objekt i vlerësimit të jashtëm institucional me qëllim vlerësimin e shkallës së përmbushjes së Standardeve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë. Akreditimi i dytë institucional i UT-së u vlerësua me një kohëzgjatje prej 4 vitesh akademike. Me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të lëna prej GVJ, institucioni përpiloi një plan veprimi. (Vendim i SA-së n. 26, datë 22.10.2020 "Për miratimin e planit vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore në UT").</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjsteve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Mbështetur nga takimet e organizuara me Njësine e sigurimit të cilësisë në Fakultet, konstatohet se janë realizuar trajnime me stafin akademik dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët. Po ashtu dhe në <i>Manualin e sigurimit të cilësisë, Rregulloren për sigurimin e cilësisë, Paketën e instrumenteve të cilësisë</i> të hartuara nga UT-së, parashikohen instrumentet e kërkimit dhe procedurat që duhet të ndjekë institucioni me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet një sërë instrumentesh. Në mënyrë periodike, nëpërmjet KPSSC në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, nga analiza e të cilit përpunohet një plan masash për përmirësim. (Evidenca III.4).</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------




<p>Kriteri 1. Institucioni ngrë njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Në nivel departamenti apo programi studimi janë ngritur komisione për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë (<i>Evidenca 0.2</i>). DGJI ka ngritur Grupin GVB i cili ka në përbërjen e tij katër pedagogë dhe një studente të vitit të dytë Bachelor. Në nivel FGJH janë, gjithashtu, Zv/Dekanët për anën akademike, të cilët mbështesin dhe orientojnë politikatat për zhvillimin e monitorimin e programeve të studimit që ofrohen.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Duke u mbështetur në RVB dhe materialet zyrtare të konsultura, dëshmojmë se Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë, të tillë si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raporti vjetor I UT-së dhe analiza e procesit mësimor dhe kërkimor shkencor. (<i>Evidenca I.0.7</i>). 2. Procedura për ndryshime, miratime në programet e studimit bëhet referuar ndryshimeve në bazën ligjore apo ndryshime të diktuar nga koha dhe kërkesat e tregut të punës. (<i>Evidenca I.13</i>) 3. Pyetëtori studentor për cilësinë e mësimdhënies
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe nga sa konfirmuam gjatë takimeve, konstatojmë se NJBC e Fakultetit zhvillon anketimet e studentëve me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikatat më të mira. Metodologjia e studimit ka qenë sasiore dhe instrumenti i përdorur janë pyetësorët.</p> <p>Në kuadër të politikave të FGJH, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, NJSBC hartoi raportin për vitin akademik 2020-2021. (<i>Evidenca I.19.1</i>) (<i>I.19.5</i>).</p> <p>Rezultatet e pyetësorëve shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për Njësitë Kryesore/Bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore, aty ku shihet e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Konstatojmë se rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. KPSSC përpos raportit të analizës përpilon dhe projekt-propozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë duke e përcjellë më tej pranë strukturave përkatëse. Referuar raportit të rezultateve të pyetësorëve, si dhe rekomandimet e përpiluara prej KPSSC-së ju përcillen njësitë kryesore, të cilat realizojnë një konsultim të gjerë në çdo departament me stafin akademik, nga ku dalin edhe propozimet përkatëse. (<i>Evidenca VI.5</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për përmirësimin e cilësisë Për këtë përpilohet plani i masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit dhe mësimdhënien i cili përcillet për miratim pranë Senatit Akademik të institucionit (<i>Evidenca VI.5</i>).</p>




Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Nga informacionet e dhëna në RVB dhe nga takimet e organizuara, vërejmë se NJSBC është struktura që merret me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, të programeve të studimit në njësinë kryesore (<i>Evidenca III.2</i>). Në kuadër të politikave të UT për sigurimin e brendshëm të cilësisë, NJSBC përpilon raportin e analizës së pyetësorëve, (<i>Evidenca I.19.5</i>) i cili ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikatat më të mira. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore, aty ku shihet e nevojshme.</p> <p>Gjithashtu, vërejmë se Raporti i Vetëvlerësimit i përpiluar prej Grupit të Vlerësimit të Brendshëm në nivel Institucioni ka shërbyer si një burim i rëndësishëm informacioni për KPSSC/NJSBC dhe strukturat e institucionit të angazhuara në përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Çdo fundviti UT harton Raportin vjetor ku pasqyrohet veprimtaria institucionale duke e shoqëruar me një analizë të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor me të gjithë komponentët dhe elementët e tij. (<i>Evidenca I.0.7</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Pohojmë se për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme (<i>Evidenca I.4.0.3</i>) të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit, të tilla si pyetësorët dhe takimet takimet në grup që zhvillohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Instrumentat janë të hartuara në mënyrë të tillë që të masin dhe vlerësojnë të gjithë komponentët e programit të studimit.</p> <p>Në kuadër të sigurimit të cilësisë, duke matur vlefshmërinë e diplomës në treg, FGJH realizon studime treg për të vlerësuar programet që ofron. Gjetjet e këtyre studimeve i shërbejnë DGJI-së për përmirësim të mëtejshëm të cilësisë të programeve të saj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i</p>	<p>Konstatojmë se programi i studimit “Gjuhë Italiane”, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, ka përdorur disa metoda të drejtpërdrejta që konsistojnë në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit si dhe vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve. Sipas pohimeve nga stafi</p>

<p>cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>dhe komenteve në RVB rezulton se përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim të ngushtë me stafin akademik të NjB vlerëson përmbajtjen e kurrikulave, syllabuseve etj. Në këtë të fundit, pasqyrohen edhe rekomandimet e vitit të mëparshëm akademik për përmirësim të mëtejshëm të tij. (Evidenca RVB). Përgjegjësi i NjB realizon vëzhgime të drejtpërdrejta në auditor gjatë kryerjes së leksioneve/ seminareve etj. Në bazë të rezultateve të vëzhgimeve të kryera, përgjegjësi i NjB jep sugjerimet përkatëse dhe verifikon nëse ato janë vënë në praktikë.</p>						
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Pohojmë se përdorimi i metodave dhe instrumenteve të tërthorta konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dhënat statistikore mbi punësimin e studentëve, llojin e punës (pozicionit drejtues) dhe karrierën e tyre, të cilat janë një tregues që lidhet me cilësinë e programeve të studimit ofruar nga UT, - të qenit partner në projektin GRADUA, për krijimin e një platforme inovative të bazuar në IT për ndjekjen e të diplomuarve dhe punësimin, si edhe të krijojë sinerji konkrete midis UT dhe tregut të punës përmes sigurimit të një mjetei unifikues në dispozicion për të dy përfituesit për vlerësimin e të diplomuarve dhe performancën e sistemit arsimor dhe sigurimin e mjeteve inovative të rekrutimit (Evidenca VI.2), - takimet me bashkëpunëtorë, ekspertë të jashtëm dhe Alumni, - dhe organizim i workshop-eve të ndryshme (Evidenca VI.7) <p>Gjithashtu, mendimi i personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ merret në konsideratë jo vetëm gjatë takimeve të ndryshme që institucioni realizon në mënyrë periodike, por edhe nga vjelja dhe analiza e të dhënave marrë nga pyetësorët.</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="566 1254 981 1332"></th> <th data-bbox="981 1254 1189 1332">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1189 1254 1396 1332">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="566 1332 981 1377"></td> <td data-bbox="981 1332 1189 1377"></td> <td data-bbox="1189 1332 1396 1377" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e</p>	<p>Mbështetur në informacionin e paraqitur në RVB, pohojmë se Statuti i UT-së dhe Plani strategjik 2018-2023, parashikojnë përfshirjen e aktorëve të</p>




<p>brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidenca III.2)</i> Gjithashtu, në FGJH u krijua dhe funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në dokumentet e mësipërme të Institucionit, përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidenca III.2.1 neni 5).</i> NJSBC-siguron, në bashkëpunim me njësitë bazë dhe strukturat e tjera të njësive kryesore të UT-së, vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, studime për të vlerësuar efikasitetin e programeve të ofruara dhe cilësinë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor të personelit akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga sa evidentohet në RVB dhe nga sa rezulton gjatë vizitës në Institucion konstatohet ngritjen e NJSBC në nivel njësie kryesore dhe në nivel njësie bazë, ku bën pjesë edhe një përfaqësues nga studentët. Dekanati luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe orientimin e politikave të sigurimit të cilësisë së programit të studimit. Njëkohësisht, një tjetër tregues që dëshmon përfshirjen e studentëve është pyetësori i organizuar prej NJSBC-së në fund të çdo semestri për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për çdo lëndë. <i>(Evidenca I.19.1)</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Duke iu referuar RVB, pohojmë se vlerësimi i cilësisë së programit të studimit realizohet edhe nga studentët e çdo kursi në mënyrë anonime, duke ruajtur konfidencialitetin e tyre. Nuk ka ndodhur në asnjë rast që studentët të ankohen për shfaqje të dukurisë së diskriminimit apo pabarazisë.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vryera në lidhje</p>	<p>RVJ pohon se, me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës nëpërmjet ndarjes së përvojave midis bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumni-t, UT dhe FGJH organizon workshope mbi tregun e punës <i>(Evidenca IV.7), (Evidenca IV.2)</i> https://fgjh.edu.al/category/promovimeëorkstudy/ ku marrin pjesë autoritetet drejtuese të UT-s dhe FGJH-s, drejtues dhe përfaqësues të institucioneve publike e private, të cilët në fund të workshopeve propozojnë rekomandime për përmirësimin e marrëdhënieve bashkëpunuese institucionale.</p>




me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UT dhe FGJH i bëjnë transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit, politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit, nëpërmjet postimit në faqen zyrtare web të UT dhe FGJH. https://fgjh.edu.al/zyra-e-vleresimit-te-cilesise-dhe-kurrikules/
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Konfirmojmë nga sa referohet në raport se në zbatim të VKM Nr. 531, datë 11.09.2018 "Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", Standardi VI. 5., Kriteri. 2 është përpiluar Raporti i Analizës së Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për çdo lëndë të çdo programi studimi. Informacioni i publikuar në raport respekton lirinë dhe etikën akademike.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	KPSSC dhe FGJH, përpos Raportit të Analizës përpiloi dhe projekt-propozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë, duke e përcjellë më tej pranë strukturave përkatëse të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve. Në përfundim të zbatimit të gjithë fazave të parashikuara në procedurën e sipërpërmendur përpilohet plani i masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit dhe mësimdhënien i cili publikohet në faqen e FGJH dhe monitorohet zbatimi i tij prej NJSBC. https://fgjh.edu.al/veprimtarite/ ; https://fgjh.edu.al/plani-i-veprimit-per-vitin-2021-2022/
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në planin e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit, është ngritur NJSBC, në nivel njësie kryesore, me qëllim përmirësimin e programit të studimit dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. (Evidenca III.2)

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë takimeve në Institucion me specialistët e zyrave përkatëse, dëshmojmë përpjekje të vazhdueshme me qëllim konsolidimin e kulturës së cilësisë. UT dhe FGJH organizojnë aktivitete dhe seminare informuese me studentët, kryesisht në trajtën e fushatave informuese me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion.		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Gjuhë Italiane” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit “Bachelor në Gjuhë italiane” është tërësisht në përputhje me Statutin, Rregulloren dhe Strategjinë e Universitetit të Tiranës dhe si dhe me Rregulloren dhe Strategjinë e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, pjesë e të cilëve është.
2. Programi i studimit “Bachelor në Gjuhë italiane” ka objektiva formuese të qarta, të mirëpërcaktuara dhe të duhura për krijimin e aftësive dhe formësimin e kompetencave të duhura tek studentët për të qenë sa më të gatshëm për përballjen me interes e tregut të punës.
3. Departamenti i Gjuhës italiane vepron në koordinim të plotë me njësitë e tjera bazë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe me strukturat drejtuese të Njësisë kryesore.
4. Angazhimi i vazhdueshëm në procesin e ndërkombëtarizimit bën që Departamenti i Gjuhës Italiane të jetë pjesë e Memorandumeve të bashkëpunimit të nëshkruara nga UT dhe pjesë e programeve të bashkëpunimit me universitete të huaja për mobilitetet të stafit akademik dhe studentëve.




5. Infrastruktura teknologjike profesionale e pasur dhe e përditësuar është në shërbim dhe në mbështetje të plotë të këtij programi studimi, duke përmbushur edhe objektivat e lëndëve specifike që ofron ky program, të tilla si fonetika, përkthim-interpretimi etj.
6. Infrastruktura fizike e FGJH është e përshtatshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe në përmbushje të objektivave të mësimdhënies.
7. Marrëveshja e vazhdueshme për praninë e një lektori italian, është një mbështetje shumë e mirë për realizimin e objektivave formuese të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Italiane”.
8. Kualifikimi i personelit akademik me kohë të plotë dhe atij me kontratë, që është i angazhuar në këtë program studimi është në përputhje të plotë me natyrën dhe me specifikat e këtij programi.
9. Studentët janë pjesë e vazhdueshme e punës kërkimore – shkencore, pjesë e konferencave dhe e projekteve që zhvillon apo edhe projekteve ku është pjesë ky program studimi.
10. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në organet e vendimarrjes apo proceset e ndryshme të rritjes së cilësisë. Grupi i hartimit të RVB ka gjithashtu në përbërjen e tij një student.
11. Organizime të vazhdueshme të takimeve dhe ditëve të informimit me studentët e ardhshëm të programit të studimit si dhe bazë materiale e pasur për promovimin e këtij programi.
12. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë lehtësisht bibliotekat on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit si U LIBRARY dhe JSTORE përmes shërbimit të faqes web të UT me akses në libraritë online
13. Mbështetja financiare e institucionit për stafin akademik me kohë të plotë, për të mbështetur kërkimin shkencor përmes pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare të organizuara në vendet e BE-së apo financime të projekteve të propozuara nga ky program studimi ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe performancës së stafit akademik.
14. Sistemi i brendshëm sigurimit të cilësisë, funksionon si një rrjet i mirëorganizuar dhe shtrin funksionin e tij në të gjitha departamentet e njësisë kryesore. Ky sistem bazohet në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, Manualin, në Instrumentat e Sigurimit të Cilësisë dhe në udhëzimet përkatëse të Ascal.

Pika të dobta:

1. Departamenti i Gjuhës italiane duhet të krijojë me tepër marrëdhënie të drejtpërdrejta me alumnin, për të kuptuar problematikën e rënies së numrit të studentëve në mënyrë që të rimerret vijueshmëria dhe të rritet numri i maturantëve që përzgjedhin këtë program studimi. Gjurmimi




më i shpeshtë i ish - studentëve do të ndihmonte më shumë jo vetëm në të kuptuarin e vlerës së programit, por do të lidhte dhe nxiste më shumë faktorë të jashtëm për përkrahjen e ecurisë së tij. (Standarti II.4, kriteri 9)

2. Mungojnë grupet mësimore në zbatim të neneve 14, 19 të Statutit të UT-s. (Standarti II.2, kriteri 2)
3. Mungon hapësira fizike e mjaftueshme e zyrës së Departamentit. Si rrjedhojë, veshtiresohet puna individuale dhe ndervepruese e personalit akademik, duke cenuar rritjen e cilësisë së performancës së tyre institucionale dhe akademike. (Standarti IV.2, kriteri 1)
4. Mungon figura e kujdestarit të studentëve në zbatim të nenit 127 të Statutit të UT-së. Pavarësisht ekzistencës së një strukture drejtuese në shërbim të studentëve, që është Zv.Dekani për marrëdhëniet me studentët, që lehtëson harmonizimin e marrëdhënieve me studentët, figura e kujdestarit me atributet që i cakton Statuti do të përbënte një hallkë të rëndësishme në këtë marrëdhënie. (Standarti V.6, kriteri 2)

Rekomandime:

1. Rekomandohet që të krijohen hapësira fizike të mundshme me qëllim përmirësimin e kushteve të punës së stafit akademik të këtij programi studimi dhe për rrjedhojë të rritjes së cilësisë së performancës së tyre institucionale dhe akademike.
2. Rekomandojmë që Departamenti i Gjuhës italiane duhet të krijojë me tepër marrëdhënie të drejtpërdrejta me Alumni-n për të kuptuar problematikën e rënies së numrit të studentëve në mënyrë që të rimerret vijueshmëria dhe të rritet numri i maturantëve që përzgjedhin këtë program studimi.
3. Rekomandohet figura e një kujdestari në shërbim dhe në mbështetje të studentëve, në zbatim të Statutit. Pavarësisht ekzistencës së një strukture drejtuese në shërbim të studentëve, që është Zv.Dekani për marrëdhëniet me studentët, që lehtëson harmonizimin e marrëdhënieve me studentët, figura e kujdestarit me atributet që i cakton Statuti do të përbënte një hallkë të rëndësishme në këtë marrëdhënie.



Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program "Bachelor in the Italian Language" of the Higher Education Institution "University of Tirana"

Strengths and Affirmations

1. The study program "Bachelor in the Italian Language" is entirely in accordance with the Statute, Regulation and Strategy of the University of Tirana as well as with the Regulation and Strategy of the Faculty of Foreign Languages, of which it is part.
2. The study program "Bachelor in the Italian Language" has clear, well-defined and appropriate formative objectives for creating skills and shaping the appropriate competencies in students to be as ready as possible to face the interests of the labour market.
3. The Italian Language Department operates in full coordination with other basic units of the Faculty of Foreign Languages and with the administrative structures of the Main Unit.
4. The continuous commitment to the internationalization process means that the Italian Language Department is part of the Cooperation Memorandums signed by the University of Tirana and part of the cooperation programs with foreign universities for the mobility of academic staff and students.
5. This study program is fully supported by a rich and updated professional technological infrastructure, which also fulfils the objectives of the specific subjects that this program offers, such as phonetics, translation-interpretation, etc.
6. The physical infrastructure of the Faculty of Foreign Languages is adequate for the smooth running of the study program and in fulfilling the teaching objectives.
7. The continuous agreement for the presence of an Italian lecturer is a very good support for the realization of the formative objectives of the study program Bachelor in "Italian Language".
8. The qualification of the full-time and on-contract academic staff, who are engaged in this study program, is in full accordance with the nature and the specifics of this program.
9. The students are a constant part of not only the research-scientific work, conferences and projects arranged but also projects this study program is a part of.
10. Students have their representatives in the decision-making bodies or the various quality improvement processes. The Internal Evaluation Report drafting group also has a student in its composition.
11. Continuous organization of meetings and information days with future students of the study program as well as a rich material basis for the promotion of this program.



12. For teaching and learning, academic staff and students can easily access online libraries of fields that are similar or related to the study program such as ULIBRARY and JSTORE through the University of Tirana website service with access to online libraries.
13. The institution's financial support for full-time academic staff to support scientific research through participation in international conferences organized in EU countries or funding of projects proposed by this study program directly affects the increase in the quality of scientific research and performance of the academic staff.
14. The internal quality assurance system works as a well-organized network and extends its function to all departments of the main unit. This system is based on the Quality Assurance Regulation, the Manual, the Quality Assurance Instruments and the relevant Albanian Quality Assurance Agency guidelines.

Weak points

1. The Department of Italian Language should create even more direct relations with the alumni, to understand the problem of the decrease in the number of students in order to regain continuity and increase the number of high-school graduates who choose this study program. More frequent tracking of former students would not only help understand the value of the program but would connect and encourage other external factors that enhance its progress. *(Standard II.4, chriterea 9)*
2. There are no teaching groups as provided by Articles 14 and 19 of the University of Tirana Statute. *(Standard II.2, chriterea 2)*
3. There is a lack of sufficient physical space for the department office. As a result, the individual and interactive work of the academic staff becomes difficult, undermining the increase of their institutional and academic performance quality. *(Standard IV.2, chriterea1)*
4. The figure of the student caretaker, as provided by Article 127 of the University of Tirana Statute, is missing. Despite the existence of an administrative structure at the service of students, the Vice Dean for relations with students, who facilitates the harmonization of relations with students, the figure of the caretaker with its attributes provided by the Statute would constitute an important link in this relationship. *(Standard V.6, chriterea 2)*



Recommendations:

1. It is recommended that possible physical spaces be created to improve the working conditions of the academic staff of this study program and therefore increase their institutional and academic performance quality.
2. We recommend that the Italian Language Department should establish more direct relations with the Alumni to understand the problem of the decrease in the number of students in order to regain continuity and increase the number of graduates who choose this study program.
3. The figure of a caretaker in the service and support of students, as provided by the Statute, is recommended. Despite the existence of a management structure at the service of students, which is the Vice Dean for relations with students, which facilitates the harmonization of relations with students, the figure of the caretaker with its attributes assigned by the Statute would constitute an important link in this relationship.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X